



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 716 prot.

Tiranë, më 15.04. 2026

V E N D I M

Nr. 88, datë 15 .04 . 2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi², mori në shqyrtim ankesën nr. 259 Regj., datë 10.11.2025, paraqitur nga M.A , kundër z. R.A , në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjinisë”, “bindjes filozofike”, “pamjes së jashtme” dhe në kuadër të “çdo shkak tjetër” profesioni në mbrojtje të të drejtave të grave dhe të drejtave të njeriut,.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit pala ankuese parashtroi ndërt të tjera:

“ Në datë 28 tetor 2025, në televizionin A2CNN u realizua emisioni *Off the Record* nga Andrea Danglli, i publikuar me titull “Barazia gjinore, plas sherri mes R.A t, H. dhe Pastorit A. P”, që gjendet online në platformën YouTube në link-un:

<https://www.youtube.com/watch?v=B3KixujrXto&t=1331S>

Unë M.A isha një nga të ftuarat në emision, së bashku me të ftuarit A.H, A.P, Z I dhe R.A .

Prej vitit 2009, Mirela punon si Drejtuese Ekzekutive e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC), një organizatë lidere në fushën e barazisë gjinore, fuqizimit të grave dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Nën drejtimin e saj, GADC është shndërruar në një nga aktorët më me ndikim në hartimin dhe zbatimin e politikave gjinore, në promovimin e pjesëmarrjes së grave në vendimarrje, si dhe në ngritjen e mekanizmave të përgjigjes ndaj dhunës me bazë gjinore.

¹ Në vijim referuar me LMD.

² Në vijim referuar me Komisioneri.

Mirela ka udhëhequr dhjetëra projekte kombëtare dhe rajonale në bashkëpunim me organizata ndërkombëtare si UN Women, ADA, BE, NED, OSCE dhe RCC, duke synuar forcimin e rolit të shoqërisë civile në proceset demokratike dhe zhvillimin e politikave të ndjeshme gjinore. Ajo ka kontribuar drejtpërdrejt në përgatitjen e raporteve kombëtare për zbatimin e Konventës së Stambollit, Platformës së Pekinit dhe Agjendës 2030 për Qëndrim të Zhvillueshëm (SDG 5).

Puna e saj është përqëndruar edhe në trajnimin e institucioneve shtetërore, parlamentit dhe pushtetit vendor mbi integrimin gjinor në buxhetim dhe vendimarrje. Ajo është autore dhe bashkëpunuese e publikimeve të shumta mbi barazinë gjinore, pjesëmarrjen politike të grave dhe llogaridhënien publike. Përkushtimi i saj i vazhdueshëm ndaj drejtësisë sociale dhe të drejtave të grave e ka bërë një nga figurat më të respektuara në lëvizjen për barazi gjinore në Shqipëri dhe rajon.

Tema e trajtuar në emision ishte projektligji “Për Barazinë Gjinore” 2025. Në shpjegim të kontekstit kohor dhe simbolik në të cilin u zhvillua ky emision, theksoj se muajt shtator-tetor 2025 përfaqësojnë një periudhë gjatë së cilës projektligji “Për Barazinë Gjinore” është trajtuar gjerësisht në media dhe ka qenë i hapur në një proces konsultues nga Kuvendi i Shqipërisë.

Unë, M.A , kam qenë një figurë e zëshme dhe aktive gjatë gjithë kësaj periudhe në mbrojtje të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në Shqipëri. Gjatë procesit të diskutimit publik dhe institucional mbi projektligjin për barazinë gjinore, kam qenë e ftuar në një sërë daljesh televizive, ku kam kontribuar në sqarimin e përmbajtjes, objektivave dhe rëndësisë së këtij projektligji për shoqërinë shqiptare.

Kam qenë vazhdimisht prezente në një fushatë informuese dhe ndërgjegjësuere në rrjetet sociale, duke ndarë analiza, komente dhe materiale edukative që synonin të kundërshtonin keqinformimin dhe të nxisin një debat publik konstruktiv. Në këtë kuadër, kam marrë pjesë aktive në seanca dëgjimore të komisioneve të ndryshme parlamentare, duke paraqitur qëndrimet dhe rekoamndimet e shoqërisë civile mbi përmirësimin e dispozitave të ligjit.

Gjithashtu, në cilësinë e Drejtueses së Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) dhe në bashkëpunim me rrjete të organizatave partnere, kam mbajtur deklaratën për shtyp të datës 21 tetor 2025 në emër të 23 organizatave të shoqërisë civile, për të dënuar fushatën e dezinformimit dhe gjuhën e urrejtjes ndaj aktivisteve për të drejtat e grave. Në tërësi, angazhimi im gjatë kësaj periudhe ka qenë i përqëndruar në informimin publik, mbrojtjen e integritetit të nismave ligjore progresive dhe forcimin e zërit të grave në hapësirën publike dhe politike, duke kontribuar për një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë.

Pretendoj se këto thënie të subjektit ndaj të cilit drejtohet kjo ankesë, z. R.A , në një televizion shqiptar të ndjekur nga mijëra qytetarë, janë të papranueshme dhe përbëjnë gjuhë urrejtje ndaj

meje, në kuptim të nenit 3, pika 8 e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shkak se jam e vetmja grua në atë panel (shkaku i mbrojtur gjinia), që po mbroj hapur qëndrimin tim ndaj projektligjit “Për Barazinë Gjinore” 2025 (shkaku i mbrojtur Bindja filozofike). Më tej, pretendoj se thënie “je një figurë shumë e shëmtuar” dhe “figurë neveritëse”, lidhen me përdorimin e gjuhës së urrejtjes për shkak të pamjes së jashtme, karakteristikë gjithashtu e mbrojtur nga neni 1, i ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Gjithashtu, kam pretenduar si shkak diskriminimi në formën e gjuhës së urrejtjes edhe “cdo shkak tjetër”, në kuptim të nenit 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke mbajtur parasysh funksionin që ushtroj, pra marrëdhënien e punësimit dhe profesionin tim në mbrojtje të të drejtave të grave dhe të drejtave të njeriut.

Sipas parashikimit të nenit 3, pika 8, e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji. Z. R.A, mes shprehjes në publik, në emisionin në fjalë më ka denigruar, shqetësuar, fyer dhe stereotipizuar negativisht si grua, profesioniste e të drejtave të njeriut dhe si person i ftuar në emision për të dhënë qëndrimin tim.

Në përputhje me nenin 1 dhe nenin 3, pika 8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 18 të Kushtetutës, si dhe me standardet ndërkombëtare të së drejtës së detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, në bazë të neneve 5, 112 dhe 122 të Kushtetutës, gjuhë urrejtje konsiderohet çdo formë shprehjeje në publik që synon ose rezulton në denigrim, fyerje, nxitje urrejtje apo stigmatizim ndaj një personi apo grupi personash për shkak të një ose disa karakteristikave të mbrojtura.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ):

- Neni 10, garanton lirinë e shprehjes, por lejon kufizime kur ato janë “të nevojshme në një shoqëri demokratike”, për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të të tjerëve;
- Neni 14, ndalon çdo formë diskriminimi në gëzimin e të drejtave të garantuara nga Konventa, duke përmendur shprehimisht si karakteristika të mbrojtura, ndër të tjera: seksin, mendimet politike ose cdo mendim tjetër dhe çdo status tjetër, oërfshirë atë mbi bazën e gjinisë apo “çdo status tjetër”.
- Protokolli Nr.12 i kësaj Konvente, zgjeron ndalimin e diskriminimit në çdo të drejtë të parashikuar me ligj.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në shumë vendimarrje ka theksuar se shprehjet e urrejtjes cenojnë dinjitetin njerëzor ose nxisin përbuzje ndaj një personi për shkak të

karakteristikave të mbrojtura për ligjin kufizimin e mbrojtjes në kuadër të nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.³

Rasti Aksu kundër Turqisë (GC, 2012)

Gjykata theksoi se sulmet diskriminuese mund të drejtohen ndaj një individi që përfaqëson ose identifikohet me një grup të mbrojtur, duke vlerësuar detyrimin pozitiv të shtetit për të garantuar që ligji dhe institucionet të mbrojnë efektivisht dinjitetin individual në këto raste.

Ky parim zbatohet në rastin konkret, ku unë, si grua, si profesioniste dhe si aktiviste për barazinë gjinore, u bëra objekt i një trajtimi denigrues për shkak të gjinisë sime, profesionit tim, bindjeve filozofike dhe rolit publik në atë debat si e ftuar.

Rasti Budaházy kundër Hungarisë (2021)

Gjykata përcaktoi se edhe shprehjet individuale, kur kanë përmbajtje përcmuese dhe nxisin intolerancën ndaj një personi për shkak të përkatësisë apo bindjeve të tij, bien ndesh me parimet e nenit 10, çka tregon se konteksti publik dhe natyra e gjuhës së përdorur janë më të rëndësishme në vlerësim, sesa fakti nëse shprehja është drejtuar një grupi apo një individi.

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) dhe Rekomandimi i Përgjithshëm nr.35 (2017):

Komiteti CEDAW thekson se gjuha dhe shprehjet seksiste, përfshijnë sulmet verbale, poshtërimin publik dhe talljen ndaj grave në hapësirën publike, përbëjnë forma të diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe duhet të parandalohen dhe ndëshkohen ligjërisht.

Në kuadër të kësaj ankese, ky standard referohet mbështetur në pretendimin se shprehjet “hsiterike”, “figurë e shëmtuar”, “neveri” apo “perversitet” nuk janë vetëm fyese, por forma të gjuhës seksiste të urrejtjes që synojnë të heshtin dhe të turpërojnë një grua për shkak të zërit të saj publik.

Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut (1998):

Në kuadër të kësaj deklarate, konsiderohen mbrojtës të të drejtave të njeriut “burra dhe gra të zakonshëm të cilët me veprimtarinë e tyre luftojnë për respektimin e të drejtave të njeriut, për shembull, lirinë e shprehjes, të drejtat e grave, popullatës autoktone ose personave gej, lezbike, transgjimore dhe interseks. Mund të veprojnë në mënyrë të pavarur ose në kuadër të organizatave.”. Shtetet kanë detyrimin të mbrojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut nda çdo formë dhune, kërcënimi

³ Factsheet on Hate Speech, Këshilli i Evropës, 2023. Link: https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/FS_Hate_speech_ENG.

apo diskretitimi për shkak të angazhimit të tyre publik. Sulmet verbale publike që nxisin përçmim ndaj grave aktiviste përbëjnë shkelje të këtij detyrimi.

Standardet e Këshillit të Evropës mbi gjuhën seksiste dhe gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore:

Rekomandimi CM/Rec (2019)1 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës:

Ky rekomandim përcakton “gjuhën seksiste” si çdo shprehje që përhap, nxit, promovon ose justifikon urrejtjen, diskriminimin ose dhunën ndaj grave për shkak të gjinisë, përfshirë sulmet ndaj grave që ushtrojnë funksione publike apo rolin e tyre në jetën publike.

Në këtë kuptim, shprehjet e z.Aliaj përbëjnë sulm verbal ndaj një gruaje në hapësirën publike për shkak të gjinisë dhe rolit të saj publik, duke përmbushur elementët e këtij përkufizimi.

ECRI Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme Nr.15 (2016):

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) i Këshillit të Evropës përcakton se, gjuha e urrejtjes mund të drejtohet edhe ndaj individëve dhe jo vetëm ndaj grupeve, vecanërisht kur synon t'i frikësojë, t'i poshtërojë apo t'i përjashtojë nga debati publik për shkak të përkatësisë në një grup të mbrojtur. Ky standard e bën të qartë se përçmimi publik dhe dehumanizimi ndaj një gruaje në panel televiziv përbën gjuhë urrejtje në kuptim të standardit të vendosur dhe të aplikueshëm.

Duke ju referuar të gjitha standardeve të mësipërme, pretendoj se shprehjet e përsëritura, denigruese dhe seksiste të z.R.A drejtuar personalisht ndaj meje, në një media kombëtare dhe në kontekst publik, përbëjnë gjuhë urrejtje me bazë gjinore, bindjesh filozofike, pamjes së jashtme dhe çdo statusi tjetër, duke marrë në konsideratë angazhimin tim profesional në rolin publik, në kuotim të tërësisë së legjislacionit dhe standardeve ligjore kombëtare dhe të praktikës ndërkombëtare në këtë fushë.

Fakti se në atë debat jam e vetmja grua në panel, që u sulmova për mënyrën e të folurit, pamjen time, punën që kryej dhe për rolin tim si përfaqësuese e një kauze shoqërore, asaj të barazisë gjinore, tregon qartë lidhjen midis gjuhës së përdorur ndaj meje dhe karakteristikave të mbrojtura në kuptim të standardit ligjor të vendosur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të aplikueshme në Shqipëri.

Mbi raportin e kufizimit të gjuhës së urrejtjes dhe asaj diskriminuese dhe lirisë së shprehjes:

Në bazë të ennit 1o të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është e zbatueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me nenet 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, liria e

shprehjes përbën një nga elementët thelbësorë të një shoqërie demokratike. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute. Paragrafi i dytë i nenit 10 parashikon kufizime të nevojshme “në një shoqëri demokratike”, përfshirë për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të tjerëve.

Në vijim, jurisprudenca e GJEDNJ-së ka sqaruar qartë kufizimin ndërmjet lirisë së shprehjes dhe gjuhës diskriminuese ose urrejtjes.

Në çështjen *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1976), Gjykata theksoi se liria e shprehjes mbulon jo vetëm idetë e pëlqyeshme, por edhe ato që “ofendojnë, tronditin apo shqetësojnë shtetin ose ndonjë pjesë të popullsisë”. Megjithatë, kjo mbrojtje nuk mund të shtrihet tek fjalimet që cenojnë vetë themelet e demokracisë, si dinjiteti dhe barazia njerëzore.

Në çështjen *Erkaban kundër Turqisë* (2006), Gjykata sqaroi se “toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të çdo qenieje njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike pluraliste” dhe se mund të jetë e nevojshme të sanksionohen apo edhe të ndalohen format e shprehjes që përhapin, nxisin apo justifikojnë urrejtje bazuar në intolerancë.

Në çështjen *Zemmour kundër Francës* (2022), Gjykata konfirmoi se deklaratat publike që përhapin stereotipe denigruese, edhe kur paarqiten si “opinione politike”, përbëjnë gjuhë urrejtje, vecanërisht kur bëhen në media me ndikim të gjerë, pasi ndikojnë në klimën e intolerancës dhe përcmimit në shoqëri.

Në dritën e këtyre standardeve, është e qartë se deklaratat publike, fyerjet apo diskretitetet e natyrës seksiste, mizogjiniste apo denigruese që synojnë një individ për shkak të gjinisë, bindjeve filozofike apo rolit publik, nuk përbëjnë ushtrim të lirisë së shprehjes, por abuzim me të në kuptim të nenit 17 të Konventës, i cili ndalon përdorimin e të drejtave për të cenur vetë të drejtat e tjera që Konventa mbron.

Pretendojmë se në rastin objekt i kësaj ankese, shprehjet publike me përmbajtje denigruese ndaj një gruaje aktiviste, të bëra në kontekst mediatik, me synim heshtimin e saj dhe përcmimin e rolit të saj publik, bien qartësisht në kategorinë e “fjalimeve që nxisin intolerancë dhe urrejtje” dhe, për rrjedhojë, nuk gëzojnë mbrojtje sipas nenit 10 të KEDNJ-së. Kufizimi i tyre është i ligjshëm, i domosdoshëm dhe proporcional për mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të tjerëve.

Bazuar në rrethanat e rastit të referuar në këtë ankesë dhe në standardet e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar të zbatueshëm, pretendoj se deklaratat e sipërcituara të bëra ndaj meje në emisionin *Off the Record*, nga Andrea Danglli në A2CNN, i publikuar me titull “Barazia gjinore, plas sherri mes R.A t, H. dhe Pastorit A. P”, që gjendet online në platformën YouTube në link-un: <https://www.youtube.com/watch?v=B3KixujrXto&t=1331S> nga subjekti të cilit i drejtohet kjo ankesë, z. R.A , përbëjnë diskriminim dhe mbartin elemente të gjuhës së urrejtjes ndaj meje, në

kuptim të neneve 3/8 dhe 7, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri marrjen në shqyrtim të ankesës dhe konstatimin e diskriminimit në lidhje me momentet e parashtruara në ankesë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjes nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”*

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në momentin e paraqitjes së ankesës, pala ankuese ka deklaruar se të dhënat e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk janë publike dhe nuk ka vendosur në dispozicion të dhënat për të bërë të mundur njoftimin nga ana e Komisionerit. Në këto kushte me shkresën nr. 1565/2 prot., datë 18.11.2025, Komisioneri iu drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), duke kërkuar informacion në lidhje me adresën e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

2. Me shkresën nr.4140/1 prot., datë 02.12.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, vendosi në dispozicion të Komisionerit vendbanimin e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, që rezulton për Subjektin R.A .
3. Me shkresën nr.1565/5 prot., datë 09.12.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa. Nëpërmjet kësaj shkrese, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion edhe nga Shoqëria G2 Media sh.p.k/Televizioni A2 CNN.
4. Njoftimi i subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk është bërë i mundur nëpërmjet shërbimit postar në adresën e vendosur në dispozicion nga DPGJC dhe është kthyer me shënimin “*adresë e pamjaftueshme*”.

Neni 147, i Kodit të Procedurave Administrative, sanksionon se gjatë procedurës administrative njoftimi për palët e përfshira duhet të jetë i përshtatshëm. Dispozita e mësipërme, parashikon:

- “1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit.*
- 2. Në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të vendosë mënyrën e duhur të njoftimit të veprimeve administrative apo ndonjë njoftim tjetër, në kuadrin e procedurës administrative, shqyrtimit të mjeteve ligjore administrative ose procedurës së ekzekutimit të aktit administrativ.*
- 3. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston.*

Sipas nenit 148, të Kodit të Procedurave Administrative, një dokument i shkruar mund të njoftohet nëpërmjet dërgimit me postë, mjeteve elektronike, faks apo njoftimit formal, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

Sipas nenit 151 “Vendi i njoftimit”, të Kodit të Procedurave Administrative, njoftimi bëhet në:

- a) vendbanimin ose vendqëndrimin e marrësit;*
- b) çdo vend, ku marrësi ndodhet, përfshirë dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;*
- c) selinë ose çdo vend ku ushtron veprimtarinë marrësi, nëse ky i fundit është person juridik;*
- ç) vendin e punës;*
- d) vendin e ushtrimit të veprimtarisë ose zyrën e marrësit;*
- dh) çdo vend tjetër, i specifikuar dhe i njoftuar paraprakisht nga pala.*

Sipas nenit 155 “Njoftimi nëpërmjet postës”, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

- 1. Njoftimi me postë bëhet nëpërmjet postës së thjeshtë apo të porositur.*
- 2. Për efekt të këtij Kodi, një shkresë, dërguar me postë të thjeshtë apo të porositur, vlerësohet e njoftuar në ditën e tretë nga data e postimit të dokumentit për adresat brenda Republikës së Shqipërisë, dhe ditën e pestë për adresat jashtë territorit të vendit.*

Në nenin 156 “Njoftimi nëpërmjet mjeteve elektronike”, përcaktohet:

“1. Njoftimi nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik apo me faks bëhet kur marrësi ka rënë paraprakisht dakord për këtë mënyrë njoftimi dhe nëse ligji nuk parashikon një formë tjetër të detyrueshme njoftimi.”

Përveç njoftimit me postë ose mjete elektronike, Kodi i Procedurave Administrative parashikon edhe njoftimin formal. Në nenin 157, të këtij Kodi sanksionohet se: *“Njoftimi i një shkrese mund të bëhet edhe nëpërmjet njoftimit formal, në rastet kur kjo parashikohet shprehimisht nga ligji, apo kur vendoset nga vetë organi publik.”*. Mënyrat e njoftimit formal parashikohen nga neni 158, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon si vijon: *“Njoftimi formal bëhet nëpërmjet dorëzimit personalisht, njoftimit nëpërmjet të tretit apo postës, si dhe nëpërmjet publikimit elektronik, njoftimit publik apo botimit zyrtar, sipas parashikimeve të neneve 159 deri në 163 të këtij Kodi.”*

Për të realizuar efektivisht dhe në mënyrë të përshtatshme njoftimin e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa e, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjore, Komisioneri, bazuar në nenin 162, të Kodit të Procedurave Administrative, realizoi njoftimin e z. R.A nëpërmjet njoftimit publik. Komisioneri vendosi të shfrytëzojë edhe këtë mënyrë të njoftimit formal të parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative.

Neni 162 “Njoftimi publik”, i Kodit të Procedurave Administrative përcakton:

“1. Njoftimi publik bëhet në këto raste:

- a) kur palët janë të panjohura;*
- b) kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151 të këtij Kodi;*
- c) kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatshme apo e pamundur;*
- ç) në çdo rast tjetër të përcaktuar shprehimisht nga ligji.*

2. Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/a jo, të cilit i drejtohet.

3. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni. Ky afat mund të zgjatet nga organi publik, për shkaqe të justifikuara. Data e shpalljes dhe heqjes së njoftimit përcaktohet në shkresën e vendosur në mjediset e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

4. Përveç shpalljes së shkresës në mjediset e përmendura në pikën 2, të këtij neni, organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe gjithashtu mund ta botojë edhe në shtypin e shkruar, në dy gazetatat me tirazh më të madh.

.....”

Mbështetur në nenin 162, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri shpalli Njoftimin Publik nr. 115 prot., datë 13.01.2026, për z. R.A , nëpërmjet së cilit njoftohet publikisht mbi procedurën administrative të Komisionerit mbi bazën e ankesës objekt shqyrtimi. Bashkëlidhur Njoftimit Publik u publikua edhe shkresa nr. 1565/5 pro, datë 09.12.2025 e Komisionerit drejtuar këtij subjekti. Njoftimi publik u shpall në faqen zyrtare të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe u afishua edhe në këndin e njoftimeve të godinës, ku Komisioneri ushtron aktivitetin e tij.

Pas kalimit të afatit ligjor 10 ditor të përcaktuar në nenin 162, të Kodit të Procedurave Administrative, nga ana e z. R.A nuk pati asnjë reagim zyrtar. Komisioneri procedoi në vijimësi me shqyrtimin e çështjes.

5. Në kushtet kur shoqëria G2 Media sh.p.k/Televizioni A2CNN, nuk ktheu përgjigje brenda afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 33, pika 7, të LMD, Komisioneri iu drejtuar me shkresën nr.115/1 prot., datë 13.01.2025, me një kërkesë të përsëritur për informacion. Në vijim të kësaj kërkesë, shoqëria G2 Media sh.p.k, ktheu përgjigje, e cila u administrua me nr.115/2 prot., datë 22.01.2026, duke parashtruar ndër të tjera:

Në lidhje me rastin objekt shqyrtimi ka një vendim të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), në të cilin është vendosur dënimi me gjobë në vlerën 50.000 lekë ndaj televizionit A2CNN, për mosrespektim të kërkesave ligjore për rastin e ngjarjes të ndodhur në emisionin “Off the Record” të emisionit të datës 28.10.2025. Ky vendim është komunikuar nga AMA si titull ekzekutiv ndaj të cilit është ushtruar ankim në rrugë gjyqësore. Arsytet mbi të cilat mbështetet vendimi i AMA në këtë rast janë:

- Në emisionin “Off the Records”, të datës 28.10.2025, rreth orës 20:39, mes dy të ftuarve në studio dhe në lidhje live u zhvillua një debat me shprehje dyese dhe denigruese për bindjet filozofike, pamjen etj, duke arritur në qëndrime diskriminuese sociale, gjinore etj;
- Subjekti A2CNN ka shpërndarë këto pamje të papërshtatshme edhe në rrjetet e tij sociale, duke u konsideruar si mungesë reflektimi ndaj situatës së krijuar;
- Referimi i nenit 33, të ligjit nr.97/2013, i cili përcakton detyrimin e OSHMA-ve për të mos cenuar të drejtat themelore të njeriut dhe për të respektuar rregullat e etikës dhe moralit publik.

Vlerësojmë se të treja këto arsye, edhe pse nga situata e faktike janë të vërteta, nuk lidhen me veprime apo mosveprime të qëllimshme të A2 CNN apo të drejtuesit të emisionit, por lidhen ekskluzivisht me sjelljen e të ftuarve në emision. Në këtë rast, A2 CNN dhe moderatori i emisionit kanë ndërmarrë të gjitha masat dhe përpjekjet e mundshme për të parandaluar dhe për të mos promovuar situatën diskriminuese të ndodhur.

Konkretisht, në emisionin e datës 28.10.2025, i cili ishte një transmetim “live”, në studio ndodheshin katër të ftuar për ligjin e barazisë gjinore në Republikën e Shqipërisë. Njëri prej të ftuarve, gjatë debatit diskriminoi një tjetër të ftuar për shkak të binjeve të tij, pamjes etj.

Që në momentin e parë dhe në vijim drejtuesi i emisionit, duke ia tërhequr vëmendjen të ftuarit që përdori shprehje fyese dhe diskriminuese me arsyetimin që ato janë të palejueshme. Duke qenë se emisioni transmetohej drejtpërdrejtë, kjo ndërhyrje përbën maksimumin e mundshëm të veprimit në atë situatë.

Gjithashtu, televizioni nuk e ka ftuar më pas më në studio personazhin që kreu këto deklarata diskriminuese si një mënyrë për të shmangur situata të ngjashme.

Për sa i përket shpërndarjes së materialeve video të incidentit në rrjetet sociale, dëshirojmë t'iu vëmë në dijeni se televizioni ynë përdor sisteme të inteligjencës artificiale për transmetimin “live” të programacionit, si edhe për prerjen dhe shpërndarjen automatike të pjesëve të emisioneve në rrjetet sociale. Për këtë arsye, shpërndarja e sekuencave përkatëse është kryer në mënyrë automatike dhe jo të qëllimshme.

Sapo jemi njohur me vendimin e AMA, kemi vepruar menjëherë duke fshirë të gjitha materialet që përmbanin sekuencat problematike.

Po ashtu, dëshirojmë të theksojmë se gjatë 7 viteve të operimit në tregun mediatik, televizioni A2 CNN nuk ka marrë asnjëherë më parë tërheqje vëmendje apo penalitet për shkelje të tilla të mundshme. Fakti që nuk jemi subjekt recidivist përbën provë të qartë se ky rast është i izoluar dhe nuk lidhet me praktikën apo politikën editoriale të A2 CNN.

Në këtë kuadër, zotohemi se në të ardhmen do të tregojmë kujdes maksimal, duke siguruar ndërhyrje edhe më të shpejta dhe efektive nga drejtuesit e emisioneve, si dhe duke hequr menjëherë nga rrjetet tona sociale çdo sekuencë filmike që përmban debate denigruese, kur këto ndodhin gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta.

III. Legjislacioni i zbatueshëm.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 3

Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.

Akte Ndërkombëtare

- **Akte në kuadër të Këshillit të Evropës**

Konventa e Këshillit të Evropës “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Neni 10

Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose

sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Neni 17

Ndalimi i shpërdorimit të të drejtave

Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individ, të drejtë që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.

Protokolli Nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Neni 1

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

Rekomandimi Nr. 15 i Politikës Së Përgjithshme të ECRI-t “Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes”, miratuar më 8 Dhjetor 2015 .

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI):

.....

Duke pasur parasysh që, për qëllimet e këtij Rekomandimi të Politikës së përgjithshme, *gjuha e urrejtjes duhet të kuptohet si* avokim, inkurajim apo nxitje në çfarëdo formë të denigrimit, urrejtjes

apo përgojimit të një personi apo grupe personash, si edhe si ngacmim, ofendim, stereotipizim, stigmatizim apo kërcënim ndaj personit apo grupi personash dhe justifikimi i të gjitha llojeve të mëparshme të shprehjes mbi shkaqet e "racës", ngjyrës, prejardhjes, përkatësisë kombëtare apo etnike, moshës, aftësisë së kufizuar, gjuhës, fesë apo besimit, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera personale apo statusit;

.....

U rekomandon qeverive të Shteteve anëtare që:

7. të përdorin fuqitë rregullatorë në drejtim të medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit *online* dhe median sociale) që të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe të kontestojnë natyrën e papranueshme të saj, duke u siguruar njëkohësisht që masa të tilla të mos përbëjnë shkelje të lirisë së shprehjes dhe mendimit, përmes veprimeve të mëposhtme:

- c. të inkurajojnë monitorimin dhe dënimin e përdorimit dhe përhapjes së gjuhës së urrejtjes;
- d. të inkurajojnë, kur është e nevojshme, vendosjen e kufizimeve ndaj përmbajtjes, programeve të filtrimit të fjalëve dhe teknikave të tjera të këtij lloji;
- e. të stimulojnë trajnimin e përshtatshëm për redaktorët, gazetarët dhe personave të tjerë që punojnë në sektorin e medias mbi natyrën e gjuhës së urrejtjes dhe si mund të dekurajohet përdorimi i saj;

.....

8. të specifikojnë fushën e veprimit dhe zbatueshmërinë e përgjegjësisë sipas të drejtës civile dhe administrative në rastin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes që synon apo ka pritshmërinë e arsyeshme që të nxitë aktet e dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit ndaj personave të shënjestruar, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe mendimit, përmes veprimeve të mëposhtme:

- a. të përcaktojnë përgjegjësitë e veçanta të autorëve të gjuhës së urrejtjes, të ofruesve të shërbimit të internetit, të forumeve online dhe shërbimeve të hostimit, të ndërmjetësve online, të platformave të mediave sociale, të moderatorëve të blogjeve dhe të subjekteve të tjera që zhvillojnë role të ngjashme;
- b. të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të urdhërohet fshirja e gjuhës së urrejtjes nga përmbajtja në internet dhe të bllokohen faqet e internetit që përdorin gjuhën e urrejtjes;
- c. të sigurojnë sa të jetë e mundur, përmes autorizimit ose miratimit të një autoriteti gjyqësor, që të urdhërohen publikuesit e medias (përfshirë ofruesit e shërbimit të internetit, ndërmjetësit online dhe platformat e medias sociale) që të publikojnë një lajmërim ku pranojnë se një material i publikuar prej tyre përbënte gjuhë të urrejtjes;

.....

Sipas relacionit shpjegues që shoqëron Rekomandimin, pjesa B, terminologjia, pika 7, parashikohet:

- g. "denigrim" nënkupton sulmin ndaj kapacitetit, personalitetit apo reputacionit të një apo më shumë personave në lidhje me anëtarësimin e tyre në një grup të caktuar personash;
- q. "nxitje" nënkupton deklaratat për grupe personash të cilat krijojnë rrezik të menjëhershëm diskriminimi, armiqësie apo dhune ndaj personave të grupit/grupeve;
- bb. "stigmatizim" nënkupton etiketimin e një grupi personash në një mënyrë negative;

- Rekomandimi KM/Rek (2022)16, i Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 20 Maj 2022, në sesionin e 132):

Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

1. të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e shpejtë dhe të plotë të parimeve dhe udhëzimeve që i bashkëlidhen këtij rekomandimi;

Shtojca e Rekomandimit CM/Rec(2022)16

2. Për qëllimet e këtij rekomandimi, gjuha e urrejtjes kuptohet si të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, promovojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për të karakteristikës ose statusit real ose që i atribuohet, të tilla si "raca", ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, mosha, aftësia e kufizuar, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual.

4. Në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin e llojit të përgjegjësisë, nëse ka, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, autoritetet e shteteve anëtare dhe palët e tjera të interesuara, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës, duhet të marrin të marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimin ndërmjet tyre: përmbajtja e shprehjes; konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes; qëllimi i folësit; roli dhe statusi i folësit në shoqëri; si shpërndahet apo përforcohet shprehja; aftësia e shprehjes për të çuar në pasoja të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla; natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar.

41. Media dhe gazetarët, në përpjekjet e tyre për të ofruar informacion të saktë dhe të besueshëm, duhet të shmangin përshkrimin stereotip poshtërues të individëve, grupeve dhe komuniteteve dhe t'u japin zë grupeve dhe komuniteteve të ndryshme në shoqëri, veçanërisht kur raportojnë për çështje me interes të veçantë publik dhe gjatë periudhave zgjedhore. Ata duhet të shmangin provokimin e paragjytimeve dhe të bëjnë referencë të panevojshme për karakteristikat ose statusin personal.

- **Rekomandimi KM/Rek (2019) 1, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës⁴, “Parandalimi/Luftimi i Seksizmit”.**

Komiteti i Ministrave sipas Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

....., Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

1. Të ndërmarrin masa për ta parandaluar dhe luftuar seksizmin dhe shfaqjet e tij në sferat publike dhe private dhe të inkurajojnë partnerët përkatës të zbatojnë legjislacionin, politikat dhe programet e duhura duke u bazuar në përkufizimin dhe udhëzimet e bashkëngjitura në këtë Rekomandim;
2. Të monitorojnë progresin në zbatimin e këtij Rekomandimi dhe të informojnë Komitetin (et) Drejtues kompetent(e) të Këshillit të Evropës për masat e ndërmarra dhe progresin e arritur në këtë fushë;
3. Të sigurojnë që ky Rekomandim, përfshirë shtojcën e tij, të përkthehet dhe t’iu shpërndalet (në formate të përdorshëm autoriteteve përkatëse dhe palëve të interesuara.

Shtojca e Rekomandimit KM/Rek(2019)1

Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër e seksizmit: masat për zbatim.

Përkufizimi

Për qëllime të këtij Rekomandimi, seksizmi nënkupton:

Çdo veprim, gjest, paraqitje vizuale, fjalë të thëna ose të shkruara, praktikë ose sjellje të bazuar në idenë se një person ose një grup personash është inferior për shkak të gjinisë së tyre, që ndodhë në sferën publike ose private, qoftë online apo offline, me qëllim ose efekt:

- i. të shkeljes së dinjitetit ose të drejtave thelbësore të një personi ose një grupi personash; ose
- ii. që rezulton me dëm fizik, seksual, psikologjik ose socio-ekonomik ose vuajtje për një person ose një grup personash; ose
- iv. të krijimit të një pengese për autonominë dhe realizimin e plotë të të drejtave të njeriut nga një person ose një grup personash; ose
- v. ruajtjes apo forcimit të stereotipeve gjinore.

II. Mjete dhe masa specifike për adresimin e seksizmit dhe sjelljes seksiste në zona të caktuara.

Disa fusha të veprimtarisë janë veçanërisht të prira ndaj akteve të seksizmit dhe/ose formave specifike të sjelljes seksiste; prandaj është me rëndësi parësore që përveç masave dhe mjeteve të rekomanduara në përgjithësi, të listuara në pjesën e mëparshme, të ndërmerren veprime të planifikuara për të parandaluar dhe luftuar seksizmin në këto zona,

.....

⁴ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 27 korrik 2019 në takimin e 1342-të të zëvendësministrave.

II.B. Gjuha e urrejtjes seksiste në internet dhe rrjete sociale.

Seksizmi në internet është i përhapur në të gjithë Evropën, me gra të prekura në mënyrë disproporcionale - veçanërisht gratë dhe vajzat e reja, gra gazetare, politikanë, figura publike dhe mbrojtëse të të drejtave njerëzore të grave. Sulmet në internet jo vetëm që prekin dinjitetin e grave, por gjithashtu mund të pengojnë gratë, qoftë edhe në vendin e punës, të shprehin mendimet e tyre dhe kjo rezultoi me shtyrjen e tyre jashtë hapësirave në internet, duke dëmtuar të drejtën e fjalës dhe mendimit të lirë në një shoqëri demokratike, duke kufizuar mundësitë profesionale dhe duke thelluar deficitin demokratik gjinor.....

..... Ndonëse është pranuar se gjuha e urrejtjes raciste është në kundërshtim me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, e njëjta nuk është gjithmonë e vërtetë për gjuhën e urrejtjes seksiste ose misogyniste dhe politikën dhe legjislacionin aktual në të gjitha nivelet nuk kanë qenë në gjendje ta adresojnë këtë çështje në mënyrën e duhur. Prandaj, shtetet inkurajohen të marrin përgjegjësi për luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe të sigurojnë që të njëjtat rregulla që ekzistojnë për gjuhën e urrejtjes raciale të vihen në zbatim edhe për gjuhën e urrejtjes seksiste sidomos kur bëhet fjalë për përdorimin e sanksioneve të legjislacionit penal.

Për më tepër, inteligjenca artificiale paraqet sfida në vete në lidhje me barazinë gjinore dhe stereotipet gjinore. Përdorimi i algoritmeve mund të transmetojë dhe forcojë stereotipet ekzistuese gjinore dhe në këtë mënyrë mund të kontribuojë në përjetësimin e seksizmit.

II.C. Produkte dhe shërbime në media, reklamime dhe komunikime të tjera.

Seksizmi në media - elektronike, të shtypit, transmetuese dhe audio - kontribuon në krijimin e një mjedisi që toleron dhe banalizon seksizmin "e përditshëm". Ai shprehet përmes:

- përshkrimeve seksuale, seksualizuese dhe raciale të grave, burrave, vajza dhe djemtë, përfshirë në reklama, filma, televizion, video lojëra dhe materiale pornografike;
- raportimeve përçmuese ose minimizuese për pamjen, veshjen dhe sjelljen e grave, në vend të diskutimeve të barazpeshuara dhe të informuara rreth pikëpamjeve dhe mendimeve të tyre;
- prezantimit dhe imagjinimit të grave dhe burrave në role stereotipike brenda familjes dhe komunitetit;
- riprodhimit dhe përforcimit të stereotipeve gjinore në lidhje me viktimat e dhunës me bazë gjinore;
- përfaqësimit jo të barabartë dhe mungesës së pjesëmarrjes domethënëse të grave në role të ndryshme profesionale dhe informuese (eksperte, komentuese), veçanërisht në lidhje me gratë e pakicave.

Në kuadër të Këshillit të Europës janë miratuar një sërë aktesh në lidhje me mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, si:

- Deklarata e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, datë 6 shkurt 2008, “Për mbrojtjen e të drejtave të mbrojtësve të të drejtave të njeriut”;
- Rezolutat e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës 1660 (2009) dhe 1891 (2012) “Mbi situatën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Këshillit të Europës”;
- Rezoluta 2095 (2016) dhe Rekomandimi 2085 (2016) Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Mbi forcimin e rolit dhe mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Këshillit të Europës”;
- Rezoluta 2225 (2018) dhe Rekomandimi 2133 (2018) Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Këshillit të Europës”
- Rekomandimi CM/Rec(2018)11 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi nevojën për të forcuar mbrojtjen dhe promovimin e hapësirës së shoqërisë civile në Evropë (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 28 nëntor 2018, në takimin e 1330-të të Zëvendës Ministrave).

Në rastin e Këshillit të Evropës, Komiteti i Ministrave miratoi në vitin 2008 Deklaratën mbi veprimin e Këshillit të Evropës për të përmirësuar mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe për të promovuar aktivitetet e tyre. Deklarata e Komitetit të Ministrave nuk jep një përkufizim të mbrojtësve të të drejtave të njeriut, por i referohet Deklaratës së OKB-së për mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

Në vitin 2018, Komiteti i Ministrave i përkufizoi mbrojtësit e të drejtave të njeriut si “*kushdo që, individualisht ose me të tjerë, vepron për të mbrojtur ose promovuar të drejtat e njeriut, pavarësisht nga profesioni i tij/saj ose statusi tjetër, dhe se institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe shoqëria civile, rganizatrat që punojnë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut janë mbrojtëse të të drejtave të njeriut.*”⁵.

Nga ana tjetër, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) ka përdorur një përkufizim edhe më të gjerë të mbrojtësve të të drejtave të njeriut si “*ata që punojnë për të drejtat e të tjerëve*”.⁶

- Akte të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. (OKB)

Konventa e Kombeve të Bashkuara “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave” (CEDAW)

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "diskriminim ndaj grave" nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë, ose të

⁵ Rekomandimi CM/Rec (2018)11 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi nevojën për të forcuar mbrojtjen dhe promovimin e hapësirës së shoqërisë civile në Evropë.

⁶ Rezoluta 2225 (2018) e Asamblesw Parlamentare tw Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Këshillit të Europës”

shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të gruavë, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

Neni 2

Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave.

Neni 3

Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme në të gjitha fushat, veçanërisht në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjislacionin, për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat.

Neni 5

Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme:

- a. Për të ndryshuar karakteristikat dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes së burrave dhe të grave, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore, dhe të gjitha praktikat e tjera që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit apo të tjetrit gjini ose në rolet stereotipe të burrave dhe të grave;

Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 28 mbi detyrimet thelbësore të shteteve palë sipas nenit 2 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, miratuar Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)

8. Neni 2 u bën thirrje shteteve palë të dënojnë diskriminimin ndaj grave në "të gjitha format e tij", ndërsa neni 3 i referohet masave të përshtatshme që Shtetet palë pritët të marrin "në të gjitha fushat" për të siguruar zhvillimin dhe përparimin e plotë të grave. Nëpërmjet këtyre dispozitave, Konventa parashikon shfaqjen e formave të reja të diskriminimit që nuk ishin identifikuar në kohën e hartimit të saj.

9. Sipas nenit 2, shtetet palë duhet të trajtojnë të gjitha aspektet e detyrimeve të tyre ligjore sipas Konventës për të *respektuar, mbrojtur dhe përmbushur/realizuar* të drejtën e grave për mosdiskriminim dhe për gëzimin e barazisë..... *Detyrimi për të mbrojtur* kërkon që shtetet palë të mbrojnë gratë nga diskriminimi nga aktorët privatë dhe të ndërmarrin hapa që synojnë drejtpërdrejt eliminimin e praktikave zakonore dhe të të gjitha praktikave të tjera që paragjykojnë dhe përjetësojnë nocionin e inferioritetit ose epërsisë së secilës prej gjinive, si dhe të stereotipeve për burrat dhe gratë.

22. I pandashmëm nga parimi i barazisë midis burrave dhe grave, ose barazisë gjinore, është koncepti që të gjitha qeniet njerëzore, pavarësisht nga seksi, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale, të ndjekin karrierën e tyre profesionale dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizimet e vendosura nga stereotipet, role dhe paragjykime të ngurta gjinore.....

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 2

1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t'u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër.

Neni 5

1. Asnjë dispozitë e këtij Pakti nuk mund të interpretohet asisoj sikur i njeh një shteti, një grupi ose një personi çfarëdo të drejte për të zhvilluar ndonjë veprimtari ose për të kryer një veprim që synon prishjen e të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Pakt ose kufizimin e tyre në një shkallë më të gjerë se sa parashikohet me këtë Pakt.

Neni 19

1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje.
2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.
3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme:
 - (a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve;
 - (b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 26

Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës,

ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo situatë tjetër.

Deklarata mbi të Drejtën dhe Përgjegjësinë e Individëve, Grupeve dhe Organeve të Shoqërisë për të Promovuar dhe Mbrojtur të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut të Njohura Universalisht, njohur ndryshe me emërtimin Deklarata e Kombeve të Bashkuara “Mbi mbrojtësit e të drejtave të njeriut”, miratuar me konsensus nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në datën 09.12.1998⁷.

Ndërsa Deklarata nuk është një instrument ligjërësht i detyrueshëm, ajo përmban parime dhe të drejta që bazohen në standardet e të drejtave të njeriut të sanksionuara në instrumente të tjera ndërkombëtare ligjërësht të detyrueshme që janë ligjërësht të detyrueshme. Për më tepër, miratimi i Deklaratës nga Asambleja e Përgjithshme me konsensus përfaqëson një angazhim shumë të fortë nga Shtetet për zbatimin e saj.

Në kuadër të Deklaratës mbi mbrojtësit e të drejtave të njeriut (shih shtojcën I), konsiderohen mbrojtës të të drejtave të njeriut "individë, grupe dhe organizata ... që kontribuojnë në ... eliminimin efektiv të të gjitha shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" (paragrafi i katërt i preambulës).

Sipas Deklaratës, ndër të tjera shtetet kanë kanë përgjegjësinë dhe detyrën, të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur “mbrojtësit e të drejtave të njeriut” kundër çdo forme dhune, kërcënimi, hakmarrjeje, diskriminimi, presionit ose çdo veprimi tjetër arbitrar, si pasojë e ushtrimit legjitim të të drejtave të përmendura në Deklaratë;

Shumica e organizatave ndërkombëtare mbështeten në këtë qasje.

- Akte të Bashkimit Evropian

Zbatimi dhe interpretimi i legjislacionit kombëtar, i cili është përafruar plotësisht ose pjesërisht me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE), në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE, bëhet duke mbajtur në konsideratë kuadrin ligjor të BE.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

Neni 11

Liria e shprehjes dhe e informimit

⁷ <https://docs.un.org/en/A/RES/53/144>

1. Kushdo ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit si edhe për të marrë e për të dhënë informacion dhe ide pa ndërhyrje nga autoriteti publik dhe pavarësisht nga kufijtë.
2. Liria dhe pluralizmi i medias respektohen.

Neni 20

Barazia para ligjit

Të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Neni 21

Mosdiskriminimi

1. Ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkaqe të tilla siç janë gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike apo sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja apo besimi, mendimet politike apo të llojeve të tjera, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, mosha apo orientimi seksual. 2. Brenda fushës së zbatimit të Traktateve dhe pa cenuar asnjë prej dispozitave të caktuara të tyre, ndalohet çdo diskriminim për shkak të shtetësisë.

Neni 23

Barazia midis grave dhe burrave

Barazia midis grave dhe burrave garantohet në të gjitha fushat, përfshirë marrjen në punë, punën dhe shpërblimin për punën

Neni 52

Fusha e veprimit dhe interpretimi i të drejtave dhe parimeve

1. Çdo kufizim për ushtrimin e të drejtave dhe lirive që njihen nga kjo Kartë mund të vendoset vetëm me ligj dhe të respektojë thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Mund të bëhen kufizime, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm nëse ato janë të nevojshme dhe nëse në të vërtetë i përmbushin objektivat e interesit të përgjithshëm të njohura nga Bashkimi apo nevojën për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e të tjerëve.
3. Për aq sa të drejtat që përmban kjo Kartë përputhen me të drejtat që garantohen nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, kuptimi dhe fusha e veprimit të këtyre të drejtave është e njëjtë me ato të të drejtave që parashikon kjo Konventë. Kjo dispozitë nuk e pengon të drejtën e Bashkimit që të parashikojë një mbrojtje më të gjerë.

Neni 53

Niveli i mbrojtjes

Në këtë Kartë asgjë nuk interpretohet si kufizuese apo cenuese për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ashtu siç njihen, në fushat përkatëse të zbatimit nga e drejta e Bashkimit dhe e drejta ndërkombëtare si dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Bashkimi dhe Shtetet Anëtare janë palë, përfshirë Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, dhe nga kushtetutat e Shteteve Anëtare.

Neni 54

Ndalimi i abuzimit me të drejtat

Në këtë Kartë asgjë nuk interpretohet se nënkupton të drejtën për t'u angazhuar në veprimtari apo për të kryer ndonjë veprim që synon shkatërrimin e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të njohura nga kjo Kartë apo kufizimin e tyre në një masë më të madhe nga ç'parashikohet këtu.

Udhëzimet e BE-së për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut⁸, miratuar në vitin 2016, referojnë tek Deklarata e Kombeve të Bashkuara “Mbi mbrojtësit e të drejtave të njeriut”, e vitit 1998.

- Legjislacioni kombëtar

Ligji Nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar⁹

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, *gjininë*, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

⁸ https://www.eeas.europa.eu/eeas/eu-guidelines-human-rights-defenders_en

⁹ Përafruar plotësisht me:

1. 32000L0043, Direktivën e Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”.
2. 32000L0078, Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
3. 32004L0113, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime”.
4. 32006L0054, Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Neni 3

Përkufizimet

1. “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

8. “*Gjuha e urrejtjes*” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Neni 5

Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7

Mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.

Ligji Nr.9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”¹⁰

Neni 3

Parimet themelore

1. Ky ligj bazohet në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit dhe në parimet e tjera, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”, si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk duhet të interpretohen apo zbatohen në mënyrë që të kufizojnë apo reduktojnë garancitë për arritjen e barazisë gjinore, të shprehura në aktet ndërkombëtare të

¹⁰ Ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën që ka ndodhur ngjarja objekt shqyrtimi i ankesës.

ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, *acquis communautaire* të Bashkimit Europian, konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.

Neni 26

Barazia gjinore në media

1. Media ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe të meshkujve:
 - a) përmes raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore;
 - b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor;
 - c) përmes shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet.
2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njërës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

Ligj Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹¹.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

36/1. “*Seksizëm*” është çdo akt, veprim, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna në median audiovizive, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, *online* ose *offline*, me efekt dhe qëllim dhunimin e dinjitetit të njeriut, të drejtat dhe liritë themelore të një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi, që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një personi apo grupi personash, shtetas shqiptarë, të huaj apo pa shtetësi ose që krijon apo ushqen krijimin e një mjedisi që ngjall frikë, armiqësor, degradues, fytes ose poshtërues, ose ushqen apo synon ruajtjen dhe përforcimin e stereotipave gjinorë.

Neni 32

Rregulla të përgjithshme për ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe/ose audiovizive dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove

4. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, si dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove nuk transmetojnë programe me përmbajtje që:

a) nxisin dhunë ose urrejtje kundrejt një grupi personash ose një anëtari të një grupi mbi baza të tilla, si: gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, tiparet gjenetike, gjuha, feja, besimi,

¹¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me direktivën 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë” (Direktiva për Shërbimin Mediatik me Zë dhe Figurë, versioni i kodifikuar).

opinionit politik, kombësia, anëtarësimi i një pakice kombëtare, prona, lindja, paaftësia, moshë apo orientimi seksual, si dhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;

Neni 33

Detyrimet e OSHMA-ve

1. Ofruesi i shërbimit mediatic audioviziv duhet:

.....

ç) të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut;

Kodi i Transmetimit për Mediat Audiovizive, miratuar me vendimin nr.60, datë 10.07.2023, të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)

Kodi i Transmetimit, i hartuar dhe i miratuar nga AMA, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 46 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, vendos rregullat, standardet dhe praktikën e transmetimit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore....

Përkufizime

Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime në Kodin e Transmetimit:

9. “Gjuha e urrejtjes” është çdo lloj shprehje, që nxit, promovon, përhap ose justifikon dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigron ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal real ose të atribuar, bazuar në: racë, ngjyrë, gjuhë, besim, kombësi, origjinë kombëtare ose etnike, përkatësi shoqërore, moshë, paaftësi, gjini, identitet gjinor, orientim seksual si dhe çdo formë tjetër diskriminimi sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara ose të shqiptuara, ose forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video.

28. “Shprehja” përfshin fjalë dhe publikime të çfarëdo forme, përfshirë edhe ato përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. “Shprehja” përfshin gjithashtu edhe përdorimin e sjelljes - si p.sh. gjesteve - për të komunikuar një ide, mesazh ose mendim apo formave të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video.

Seksioni 1

Parimet Themelore

Parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audio dhe audiovizive, e cila mbështetet në garantimin e lirisë dhe pluralizmit të mjeteve të komunikimit audio dhe audioviziv janë si më poshtë vijon:

1.1 Operatorët e shërbimit mediatik audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre respektojnë, garantojnë dhe promovojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, lirinë e shprehjes, të drejtën e informimit, parimin e mosdiskriminimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

1.6 Në transmetimet audio dhe audiovizive nuk duhet të përdoren shprehje, që përmbajnë gjuhë urrejtje, denigrim ose stigmatizim kundër një personi ose grupi personash, nuk duhet të përdoret gjuhë që promovon, nxit ose justifikon dhunën ndërmjet shtetasve në përgjithësi, dhunën me bazë gjinore në veçanti, radikalizmin, ekstremizmin dhe terrorizmin ose që nxit urrejtjen e grindjet për shkak të kombësisë, etnisë, besimit fetar, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual. Në transmetimet audio dhe audiovizive duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar, kundërvepruar, kundërshtuar dhe hedhur poshtë çdo shprehje të tillë.

Seksioni 5

Parandalimi e Luftimi i Diskriminimit Gjinor dhe Promovimi i Barazisë Gjinore

5.1 OSHMA-të garantojnë respektimin e dinjitetit njerëzor dhe ndalojnë çdo diskriminim dhe dhunim me bazë gjinore në çfarëdolloj forme të shprehjes së tyre në transmetimet audio dhe audiovizive.

5.2 OSHMA-ve u ndalohet të përdorin gjuhë urrejtjeje mbi baza seksiste në të gjitha programet, përfshirë edhe reklamat si dhe të promovojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi diskriminimin me bazë gjinore.

5.9 OSHMA-të inkurajohen të bashkëpunojnë me institucionet e barazisë, organizatat e medias dhe të shoqërisë civile dhe institucionet e specializuara në fushën e barazisë gjinore, për të promovuar portretizimin jostereotipik të gjinive në media dhe në reklama si edhe për të promovuar komunikimin me ndjeshmëri gjinore.

5.10 OSHMA-të inkurajohen të hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë politika dhe mekanizma vetërregullues për eliminimin e seksizmit, përfshirë gjuhën e urrejtjes seksiste në transmetimet audio dhe audiovizive, përfshirë reklamat dhe në sektorë të tjerë të punës së tyre, duke u mbështetur në standarde ndërkombëtare të gjithëpranuara, si treguesit e raportimit me ndjeshmëri gjinore të UNESCO-s, Udhëzimet e Këshillit të Evropës dhe të OSBE-së.

Seksioni 7

Parandalimi dhe Luftimi i Gjuhës së Urrejtjes

7.1 OSHMA-të respektojnë dhe promovojnë diversitetin, dialogun, respektin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin mbarëshoqëror.

7.2 Materiali që përmban gjuhë urrejtjeje nuk përfshihet në programet audio dhe audiovizive. Rastet përjashtimore përcaktohen prej kontekstit profesional.

7.5 Gazetarët dhe drejtuesit e programeve audio dhe audiovizive, të prodhuara nga OSHMA-të, kundërshtojnë dhe hedhin poshtë retorikën e të ftuarve apo pjesëmarrësve, që fyejnë ose denigrojnë individë të ftuar apo pjesëmarrës sipas karakteristikave të përshkruara në paragrafin 7.4.

7.10 OSHMA-të parandalojnë dhe ndalojnë stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin e grupeve shoqërore të caktuara.

7.13 OSHMA-të promovojnë veprimet për të luftuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe kontestuar natyrën e papranueshme të saj, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe mendimit.

7.14 OSHMA-të krijojnë mekanizmat vetërregullatorë, rishikojnë kodet e sjelljes dhe miratojnë ndryshimet e nevojshme për të adresuar parandalimi e gjuhës së urrejtjes gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre.

7.16 OSHMA-të mundësojnë kanale efektive të raportimit të gjuhës së urrejtjes dhe monitorojnë së brendshmi përdorimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Në rast të konstatimit të përdorimit të gjuhës së urrejtjes gjatë veprimtarisë audio/ audiovizive, ato duhet të reagojnë, ta dënojnë atë dhe të promovojnë vlerat dhe parimet.

Në datën 05.03.2019, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Rezolutën “Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë”

Në këtë Rezolutë theksohet:

Duke njohur dhe respektuar detyrimet e Republikës së Shqipërisë në promovimin dhe forcimin e vlerave demokratike në botë, në mbrojtjen e çdo mbrojtësi të të drejtave të njeriut, pa diskriminim dhe në mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë, nga dhuna, presionet ose represionet, kërcënimet, sulmet ose kanosjet nga çdo drejtim që vijnë, për shkak të veprimtarisë së tij/saj, në dobi të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;

Duke pranuar sfidat me të cilat përballen mbrojtësit e të drejtave të njeriut, duke mbrojtur të drejtat e grupeve të marginalizuara, veçanërisht të drejtat e grave, të fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara, të viktimave të dhunës dhe trafikimit, të komuniteteve të pakicave kombëtare dhe personave me orientim seksual të ndryshëm ose për shkak të identitetit gjinor të tyre (LGBTI) dhe/ose që i përkasin këtyre grupeve, të drejtat e refugjatëve, emigrantëve ose popullatave në lëvizje;

Vendosëm:

14. Të nxitim Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas të bashkëpunojnë ngushtësisht me organet e qeverisjes vendore, përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave në nivel vendor, organet e zbatimit të ligjit, organizatat/rrjetet e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare të fushës, për të promovuar dhe mbrojtur mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe aktivitetin e tyre, në nivel vendor dhe kombëtar.

IV. Analiza ligjore e fakteve dhe provave.

Faktet dhe rrethanat.

Rezulton se, në datë 28 tetor 2025, në televizionin A2CNN është transmetuar emisioni “Off the Record”, drejtuar nga gazetari Andrea Danglli. Ky emision është transmetuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë (live). Në studio kanë qenë të ftuar katër persona, ankuesja, z. Z.I, deputet z. A.A, aktivist për të drejtat e njeriut, z. A.P. Ndërsa pjesmarrës në emision nëpërmjet lidhjes “online” ka qenë subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa z.R.A . Tema e trajtuar në emision ishte projektligji “Për Barazinë Gjimore”, i cili ishte në proces konsultues nga Kuvendi i Shqipërisë.

Bazuar në provat e administruara rezulton se, gjatë emisionit nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa z.R.A , janë bërë deklaratat e mëposhtme:

Minuta 47:58, R.A deklaron: *“Ka mundësi ta mbylli gojën ajo që është aty që kakaris gjithë kohës. Çi merrni këto njerëz histerik nëpër panele mër vlla.”*

Minuta 48:53, R.A deklaron: *“Një person që kakaris gjithë kohës dhe shkatërron bisedën e pastorit.”*

Minuta 50:39, R.A deklaron: *“Ajo zonja që është aty ta qepi gojën pak.”*

Minuta 52:23, R.A deklaron (duke iu drejtuar ankueses dhe të ftuarit z.A.A): *“Ju jeni më keq se islamizmi.”*

Minuta 52:58, R.A deklaron (duke iu drejtuar ankueses dhe të ftuarit z.A.A): *“Asgjë nuk bën myzlimanizmi dhe xhihadizmi më shumë se ju.”*

Minuta 1:23:46, R.A deklaron: *“Kam një pyetje. (në këtë moment gazetari e pyet për kë është pyetja, z. Aliaj deklaron: do kuptohet nga pyetja.) Komuniteti LGBTQ+ bla bla sa herë ka protestuar në historinë e vet kundër pedofilëve, kundër abuzimit të fëmijëve që ata kaq shumë ia qajnë hallin. Pedofilizmi është një nga dhimbjet më të mëdha në Europë është një nga problemet më të mëdha dhe skandalet më të mëdha që po zbulohet përditë edhe janë fëmijët ata që i mbajnë në kurriz këta mostra. Pra këta që janë pak a shumë si të thuash një kategori pedofil-homoseksual e të gjitha janë njësoj, janë njerëz pervers, pikë, dhe kjo nuk është vetëm bindja ime. Këtë e sheh tani që wokistani po shembet në Europë, tani po dalin dhe po falsin njerëzit.”*

Minuta 1:27:04, R.A deklaron: *“Nga ana e perversitetit jeni edhe më keq. Perversiteti juaj është e njëjta kategori me pedofilinë, janë njerëz manjakë, njerëz manjakë.”*

Minuta 1:55:35, R.A deklaron (duke iu drejtuar ankueses): *“Bëhu i çik me këmbë në tokë se ti flet shumë por ai që flet shumë nuk di çfarë thotë, prandaj qetësohu aty sepse vërtet je një figurë shumë e shëmtuar, pikë. Neveri fare, je neveri. Figurë neveritëse që nuk ka të drejtë të jetë në një panel televiziv.”*

Përgjatë diskutimit të zhvilluar, gazetari ka ndërhyrë vetëm pas deklaratës së fundit të z.Aliaj duke thënë : *“Ju lutem zoti Aliaj, ju lutem, nuk është etike”*.

Gjatë periudhës shtator-tetor 2025, projektligji “Për Barazinë Gjimore” është trajtuar gjerësisht në media dhe ka qenë në një proces konsultimi nga Kuvendi i Shqipërisë.

Pala ankuese, paraqiti ankesën nr.259, datë 10.11.2025, duke pretenduar se thëniet e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa z.R.A , përbëjnë gjuhë urrejtje ndaj saj, për shkak të gjinisë, si e vetmja grua e ftuar në emision, për shkak të bindjeve filozofike, pasi ka mbrojtur hapur qëndrimin e saj për projektligjin “Për barazinë gjimore”, pamjes së jashtme, që lidhet me përdorimin e thënieve “je një figurë shumë e shëmtuar” dhe “figurë neveritëse”, si dhe për shkak të aktivitetit të saj si mbrojtëse e të drejtave të grave dhe të drejtave të njeriut., shkak ky i pretenduar në kuadër të “çdo shkakut tjetër”, sipas nenit 1, të LMD.

Vlerësimi i Komisionerit.

Dinjteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Detyrimi i shtetit është, jo vetëm të mos i cënojë vetë ato, por ai duhet të marrë masa dhe të ofrojë garancitë e duhura për të garantuar mos cënimin e tyre nga privatët, pra shteti duhet të marrë të gjitha masat për t’i mbrojtur dhe për të garantuar gëzimin e tyre nga të gjithë individët.

Barazia dhe mosdiskriminimi, janë gur themeli i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe i të drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat janë ratifikuar nga vendi ynë duke u bërë pjesë të rendit të brendshëm juridik, menjëherë pas Kushtetutës dhe me epërsi ndaj ligjeve kombëtare.

Barazia gjimore është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, funksionimin e demokracisë dhe qeverisjen e mirë, respektimin e sundimit të ligjit dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë, që ngërthen në vete të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, si dhe të njëjtin vizibilitet, fuqizim, përgjegjësi dhe pjesëmarrje në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, dhe që nënkupton një qasje dhe ndarje të barabartë të burimeve midis grave dhe burrave¹². Diskriminimi për shkak të gjinisë shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjtetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen në të njëjtat kushte të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

Liria e shprehjes është një e drejtë Kushtetuese. Liria e shprehjes, përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë dhe për të shprehur ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje. Liria e mendimit dhe e shprehjes janë thelbësore për çdo shoqëri dhe përbëjnë gurin e themelit për zhvillimin e çdo personi dhe çdo shoqërie të lirë dhe demokratike.

¹² Rekomandimi KM/Rek (2019) 1 “Parandalimi/Luftimi i Seksizmit”.

Liria e mendimit, nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi apo ndërhyrje. Asnjë person nuk mund të jetë subjekt i asnjë ndalimi ose kufizimi, për shkak të mendimeve/opinioneve të tij aktuale, të perceptuara apo të supozuara. Të gjitha format e mendimit janë të mbrojtura, duke përfshirë mendimet politike, shkencore, historike, morale ose të natyrës fetare. Liria e shprehjes, përfshin shprehjen/dhënien dhe marrjen e komunikimeve në çfarëdo lloj forme të ideve dhe mendimeve, të cilat janë të transmetueshme tek të tjerët. Kjo lloj lirie nuk është absolute dhe është subjekt i kufizimeve. Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi.

Liria e shprehjes është subjekt i kufizimeve sipas përcaktimit të nenit 17, të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, kufizimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë mund të vendoset vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Referuar KEDNJ, kufizimi i këtyre të drejtave përcaktohet nga neni 9/2 dhe 10/2 si dhe neni 17 të saj. Duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuara në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në referim edhe të evokimit që i bëhet asaj në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), me anë të të cilave bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Këto parashikime shkojnë në të njëjtën linjë edhe me rregullimin dhe nivelin e kufizimeve të zbatueshme për këto të drejta, të parashikuara nga traktatet e të drejtave të njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, të cilat vendi ynë i ka ratifikuar, sikurse është Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike. Ky traktat i të drejtave të njeriut rregullon ushtrimin dhe kufizimet e zbatueshme për këto të drejta në nenet 18/3 dhe 19/3 të tij të marra së bashku me nenin 20/2.

Sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), kufizimet e vendosura nga neni 10/2 i KEDNJ, zbatohen jo vetëm për “informacionet” ose “idetë” që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen si jofyese ose si çështje indiferente, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë shtetin ose çdo sektor të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e atij pluralizmi, tolerance dhe mendjegjerësie, pa të cilat nuk ka “shoqëri demokratike”. Kjo do të thotë, ndër të tjera, se çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizim” ose “dënim” i vendosur në këtë sferë duhet të jetë në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur”. (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 7 dhjetor 1976, paragrafi 49*).

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si një çështje parimi mund të konsiderohet e nevojshme që në shoqëri të caktuara demokratike të dënohen apo edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë apo justifikojnë

urrejtjen të bazuar tek mungesa e tolerancës. (*Erbakan kundër Turqisë, vendimi 6 korrik 2006, paragrafi 56*)

Mbështetur në paragrafin 2, të nenit 10 të KEDNJ-së, autoritetet vendase në çdonjërin nga Shtetet Kontraktues mund të ndërhyjnë me ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 (tre) kushte së bashku¹³:

1. Ndërhyrja (në kuptimin e “formalitetit”, “kushtit” ose “sanksionit”) parashikohet me ligj;
2. Ndërhyrja ka si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose vlerat e mëposhtme: sigurimin kombëtar; integritetin territorial; sigurinë publike; ndalimin e krimit dhe mbrojtjen e rendit; mbrojtjen e shëndetit; moralit; reputacionin ose të drejtat e të tjerëve; ndalimin e zbulimit të informacionit të marrë në konfidencë, dhe garantimin e autoritetit të paanshmërisë së gjyqësorit;
3. Ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Nevoja për të mbrojtur “të drejtat e të tjerëve” është një moment i rëndësishëm kufizues për të drejtën e shprehjes. Në çështjen *Engels and Others*, GJEDNJ është shprehur se: “*nuk ka arsye që të mohosh lirinë e shprehjes, por vetëm të dënosh ushtrimin abuziv të asaj lirie.....*”¹⁴.

Rezulton se ankuesja ishte e vetmja grua e ftuar në emision. Ankuesja është aktiviste për barazinë gjinore dhe Drejtuese Ekzekutive e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC), një organizatë që punon në fushën e barazisë gjinore, fuqizimin e grave dhe të drejtat e njeriut. Rezulton se gjatë procesit të diskutimit publik mbi projektligjin “Për barazinë gjinore”, i cili u miratua nga Kuvendi me ligjin nr.64/2025, datë 06.11.2025, ka qenë e përfshirë në fushata informuese dhe ndërgjegjësuëse dhe pjesë e seancave dëgjimore në komisionet parlamentare gjatë procesit të shqyrtimit të projektligjit. Në cilësinë e drejtueses së Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe në bashkëpunim me organizata të tjera të shoqërisë civile, ka mbajtur një deklaratë për shtyp në datën 21.10.2025, në emër të 23 organizatave të shoqërisë civile, për të dënuar fushatat e dezinformimit dhe gjuhën e urrejtjes ndaj aktivisteve për të drejtat e grave.

Ankuesja pretendon se, shprehjet “histerike”, “je një figurë shumë e shëmtuar”, “figurë neveritëse” apo “perversitet”, “ajo zonja aty ta mbylli gojën”, “kakaris gjithë kohës” nuk janë vetëm fyese, por forma të gjuhës seksiste të urrejtjes që synojnë të heshtin dhe të turpërojnë një grua për shkak të zërit të saj publik. Ankuesja pretendon se, shprehjet e z.Aliaj përbëjnë sulm verbal ndaj një gruaje në hapësirën publike për shkak të gjinisë dhe rolit të saj publik. Në debatin e zhvilluar gjatë emisionit ajo ishte e vetmja grua në panel, që u sulmua për mënyrën e të folurit, pamjen e saj, punën që kryen dhe për rolin e saj si përfaqësuese e një kauze shoqërore, asaj të barazisë gjinore. Ankuesja pretendon se, shprehjet e përsëritura, denigruese dhe seksiste të z.R.A drejtuar personalisht ndaj saj, në një media kombëtare dhe në kontekst publik, përbëjnë gjuhë urrejtje me bazë gjinore, bindjesh filozofike, pamjes së jashtme dhe çdo statusi tjetër, duke marrë në konsideratë angazhimin

¹³ Carss-Frisk,M., Një udhëzues për zbatimin e Nenit 10 të Konventës Evropiane - Liria e Shprehjes;

¹⁴ Engels and Others kundër Hollandës, 1976.

e saj profesional dhe në rolin publik, në fushën e barazisë gjinore, si mbrojtëse e të drejtave të njeriut.

Bazuar në nenin 1, të LMD, *gjinia* përbën një shkak të mbrojtur nga diskriminimi, përfshi gjuhën e urrejtjes për shkak të gjinisë, si një nga format e shfaqjes së diskriminimit sipas nenit 3, pika 8, të LMD.

Ankuesja pretendon se thëniet e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa z.R.A , përbëjnë gjuhë urrejtje ndaj saj, jo vetëm për shkak të gjinisë, por edhe për shkak të bindjeve filozofike, duke e lidhur këtë pretendim me faktin se ka mbrojtur hapur qëndrimin e saj për projektligjin “*Për barazinë gjinore*”.

Referuar nenit 1, të LMD, bindjet filozofike parashikohet shprehimisht si shkak i mbrojtur nga diskriminimi, por LMD nuk ka një përkufizim se çfarë konsiderohet bindje filozofike. Mungesa e një përkufizimi se çfarë do të konsiderohet bindje filozofike, si shkak i mbrojtur nga diskriminimi, konstatohet edhe për sa i përket praktikës gjyqësore. Për të vlerësuar nëse barazia gjinore përfshihen në kuadër të shkakut të mbrojtur të bindjeve filozofike, sipas përcaktimeve të LMD, Komisioneri do t’i referohet praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE)

Komisioneri konstaton se, GJEDNJ ka elaboruar idenë e “*bindjes*” në kontekstin e së drejtës për arsimim sipas nenit 2 të Protokollit 1 të KEDNJ, i cili parashikon se shteti duhet të respektojë të drejtën e prindërve për të siguruar që arsimimi i fëmijës së tyre të jetë "në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike", duke mbajtur qëndrimin se:

*“Në kuptimin e saj të zakonshëm, fjala “bindje”, e marrë në vetvete, nuk është sinonim me fjalët “opinione” dhe “ide”, siç janë përdorur në nenin 10 [...] të Konventës, i cili garanton lirinë e shprehjes; është më shumë i ngjashëm me termin “besim” (në tekstin francez: “bindje”) që paraqitet në nenin 9 [...] dhe tregon pikëpamje që arrijnë një nivel të caktuar bindjeje, serioziteti, kohezioni dhe rëndësie.”*¹⁵

GJEDNJ ka pranuar, se, veganizmi¹⁶ dhe kundërshtimi i manipulimit të produkteve me origjinë shtazore ose të testuara, konsiderohet bindje filozofike¹⁷.

¹⁵ GJEDNJ, *Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 7511/76 dhe 7743/76, 25 shkurt 1982, para. 36.

¹⁶ Praktika e mos ngrënies ose mos përdorimit të produkteve shtazore, si mishi, peshku, vezët, djathi ose lëkura: <https://dictionary.cambridge.org/dictionary/english/veganism>

¹⁷ *W. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Komisionit i 10 shkurtit 1993.

Komisioneri në praktikën e tij, ka pranuar se bindjet animaliste, bindjet e personave të cilët mbrojnë të drejtat dhe mirëqënien e kafshëve, gëzojnë mbrojtje në kuadër të shkakut “*bindje filozofike*”, të parashikuar nga neni 1, i LMD¹⁸.

Barazia gjinore, nuk është vetëm një e drejtë themelore e njeriut por është një nga parimet themelore në një shoqëri demokratike. Ajo është një e drejtë e cila gëzon mbrojtje kushtetuese dhe është e njohur nga e drejta ndërkombëtare, në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian. Barazia gjinore është një nga objektivat e rëndësishëm të Qeverisë së Shqipërisë, e cila është materializuar nëpërmjet miratimit prej vitesh të strategjive për arritjen e barazisë gjinore.

Komisioneri vlerëson se, barazia gjinore, përbën pikëpamje që arrin një nivel të caktuar bindjeje, serioziteti, kohezioni dhe rëndësie, duke plotësuar elementët për t’u konsideruar bindje filozofike në kuptim të nenit 1, të LMD.

Bazuar në aktivitetin e ankueses në mbrojtje të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesja i mbart në mënyrë të vërtetë, bindjet filozofike që lidhen me barazinë gjinore, dhe rrjedhimisht rezulton i provuar shkak i “*bindjeve filozofike*”.

Ankuesja pretendon si shkak diskriminimi në kuadër të parashikimit “*çdo shkak tjetër*”, sipas nenit 1, të LMD, për shkak të profesionit dhe aktivitetit të saj si mbrojtëse e të drejtave të njeriut.

Referuar parashikimeve që bëhen në aktet ndërkombëtare në kuadër të OKB, Këshillit të Europës, Bashkimit Europian, por edhe Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, Komisioneri vlerëson se, ankuesja, bazuar në aktivitetin e saj në mbrojtje të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, konsiderohet një mbrojtëse e të drejtave të njeriut.

Organizata e Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Europës dhe Bashkimi Evropian, nëpërmjet një sërë aktesh evidentojnë nevojën për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, të cilët për shkak të aktivitetit dhe punës së tyre janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të dhunës, kërcënimit apo formave të ndryshme të shkeljes së të drejtave të tyre.

Komisioneri vlerëson se, trajtimi i padrejtë dhe disfavorshëm që bazohet në statusin si “*mbrojtës i të drejtave të njeriut*”, duhet të gëzojë mbrojtje nga diskriminimi sipas LMD dhe përbën shkak të mbrojtur në kuptim të parashikimit “*çdo shkak tjetër*”, të nenit 1, të LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të pamjes së jashtme, Komisioneri vlerëson se, pamja e jashtme përbën shkak të mbrojtur, në kuptim të nenit 1, të LMD. Ankuesja pretendon se, thëniet “je një figurë e shëmtuar” dhe “figurë neveritëse”, lidhen me përdorimin e gjuhës së urrejtjes për shkak të pamjes së jashtme.

¹⁸ Vendim i Komisionerit Nr. 97, datë 30.04.2025.

Komisioneri vlerëson se, pamja e jashtme si shkak diskriminimi, përfshin karakteristika fizike të dukshme të një personi, të cilat mund të shërbejnë si shkak për ta trajtuar atë në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme për shkak të pamjes së tij të jashtme.

Në rastin objekt shqyrtimi, nuk pretendohet se, karakteristika fizike të dukshme, për shkak të të cilave ajo është ekspozuar ndaj gjuhës së urrejtjes.

Komisioneri vlerëson se, ndonëse shprehjet janë drejtuar ndaj pamjes së jashtme të ankueses, ato nuk kanë si shkak ndonjë krakteristikë fizike. Referencat ndaj pamjes së jashtme përbëjnë vetëm formën përmes së cilës është shprehur trajtimi i pretenduar diskriminues dhe jo shkakun e diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri e gjen në pabazuar shkakun e pretenduar të diskriminimit “*pamja e jashtme*”.

Kufizimi i gjuhës së urrejtjes duket se kërkon një pajtim të dy grupeve të vlerave: kërkesat e shoqërisë demokratike për të lejuar debat të hapur dhe autonomi dhe zhvillim individual me detyrimin gjithashtu bindës për të parandaluar sulmet ndaj komuniteteve vulnerabël dhe për të siguruar pjesëmarrjen e barabartë dhe jodiskriminuese të të gjithë individëve në jetën publike. Në këtë kontekst çështja thelbësore që shtrohet në çështjen objekt shqyrtimi, është pesha respektive që ka liria e shprehjes si dhe liria e fesë dhe besimit në raport, me të drejtën për të jetuar të lirë nga diskriminimi dhe për të gëzuar respekt të barabartë, të të gjithë personave.

Sa më sipër rezulton se, kufizimi i lirisë së shprehjes, është një kërkesë e imponuar nga parashikimi që bëhet në ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili sanksionon se gjuha e urrejtjes përbën një nga format e shfaqjes së diskriminimit dhe se çdo formë e shprehjes e ushtruar në kundërshtim me këtë ligj është e ndaluar. Gjithashtu, rezulton se, kufizimi i lirisë së shprehjes, kërkohet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, që në rastin konkret është siguri i barazisë dhe mbrojtja nga diskriminimi.

Në këtë mënyrë përmbushen dy kushtet mbi bazën e të cilave mund të kufizohet liria e shprehjes, së pari, kufizimi është vendosur bazuar në ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar dhe së dyti, për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve në rastin konkret për mbrojtjen nga diskriminimi të grave, mbrojtëse të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe të drejtave të grave dhe vajzave. Ajo që mbetet të vlerësohet është domosdoshmëria dhe proporcionaliteti.

Në vlerësimin e faktit nëse gjuha e përdorur arrin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për t’u konsideruar gjuhë urrejtje në kuptim të nenit 3, pika 8, të LMD dhe rrjedhimisht një formë diskriminimi, e ndaluar nga ligji, Komisioneri do të bazohet në udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ dhe duke marrë parasysh faktorët/elementët e përfshirë në Rekomandimin Nr.15 të

ECRI-t dhe Rekomandimin KM/Rek (2022) 16, të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës dhe ndërveprimi ndërmjet tyre.

Sipas Rekomandimit Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “*Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*”¹⁹, “*shprehja*” në këtë Rekomandim përfshin fjalët dhe publikimet në çfarëdo formë, përfshirë edhe përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara apo të shqiptuara, apo forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, piktura, muzikë, pjesë teatrale apo video. Gjithashtu, përfshin përdorimin e një sjelljeje të caktuar - siç janë gjestet - për të komunikuar një ide, mesazh apo mendim.

Kodi i Transmetimit të Mediave Audiovizive, gjithashtu përcakton në pikat 9 e 28, të tij se, “*shprehja*” përfshin fjalë dhe publikime të çfarëdo forme, përfshirë edhe ato përmes medias elektronike, si edhe përhapjen dhe ruajtjen e tyre. “*Shprehja*” përfshin gjithashtu edhe përdorimin e sjelljes - si p.sh. gjesteve - për të komunikuar një ide, mesazh ose mendim apo formave të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video. Gjuha e urrejtjes mund të marrë formën e fjalëve të shkruara ose të shqiptuara, ose forma të tjera si foto, imazhe, shenja, simbole, muzikë, vepër skenike ose video.

Neni 3, pika 8, e ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ndalon gjuhën e urrejtjes, në çdo formë të shprehjes në publik dhe me çdo mjet. Komisioneri vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi shprehja është realizuar nëpërmjet fjalëve të shqiptuara dhe në mënyrë publike, pasi shprehjet objekt i ankesës janë bërë në një platformë publike, televizionit A2 CNN një media audiovizive, që përfshihet në mjetet e nëpërmjet të cilës mund të përhapet gjuha e urrejtjes.

GJEDNJ, kur merret me çështjet që kanë të bëjnë me nxitjen e urrejtjes dhe lirinë e shprehjes, përdor dy qasje të parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

- qasja e përjashtimit nga mbrojtja e Konventës, e parashikuar nga neni 17 (ndalimi i abuzimit me të drejtat), ku komentet në fjalë përbëjnë gjuhë urrejtje dhe mohojnë vlerat themelore të Konventës; dhe;
- qasja e vendosjes së kufizimeve në mbrojtje, e parashikuar nga neni 10, paragrafi 2, i Konventës (kjo qasje zbatohet kur shprehja në fjalë, megjithëse është gjuhë urrejtjeje, nuk është e përshtatshme për të shkatërruar vlerat themelore të Konventës).

“*Gjuha e urrejtjes*”, siç është interpretuar ky koncept në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, ndahet në dy kategori.

¹⁹ Referuar, pikës 11, të Relacionit Shpjegues, që shoqëron Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “*Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*”

Kategoria e parë e praktikës gjyqësore të GJEDNJ për “gjuhën e urrejtjes” përbëhet nga format më të rënda të “gjuhës së urrejtjes”, të cilat Gjykata i ka konsideruar se i përkasin nenit 17, dhe kështu janë përjashtuar tërësisht nga mbrojtja e nenit 10.

Kategoria e dytë përbëhet nga forma “më pak të rënda” të “gjuhës së urrejtjes” të cilat Gjykata nuk i ka konsideruar se janë tërësisht jashtë mbrojtjes së nenit 10, por që ajo i ka konsideruar të lejueshme për shtetet kontraktuese t’i kufizojnë (shih, ndër të tjera, *Féret kundër Belgjikës*, nr. 15615/07, 16 korrik 2009, *Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë*, 9 shkurt 2012; *Delfi AS kundër Estonisë*, 16 qershor 2016). Në këtë kategori të dytë, GJEDNJ, jo vetëm që ka vendosur gjuhën që bën thirrje në mënyrë eksplicite për dhunë ose akte të tjera kriminale, por ka vendosur se, sulmet ndaj personave, të kryera duke fyer, tallur ose shpifur për grupe të veçanta të popullsisë, mund të jenë të mjaftueshme për të lejuar autoritetet të favorizojnë luftën kundër gjuhës paragjyquese brenda kontekstit të kufizimeve të lejuara për lirinë e shprehjes (shih *Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë*; *Vejdeland dhe të tjerët kundër Suedisë* dhe *Féret kundër Belgjikës*). Në rastet që kanë të bëjnë me gjuhën që nuk thërret për dhunë apo akte të tjera kriminale, por që megjithatë GJEDNJ i ka konsideruar si “*gjuhë urrejtjeje*”, ky përfundim është bazuar në një vlerësim të përmbajtjes së shprehjes dhe mënyrës së dhënies së saj²⁰.

Komisioneri, thekson se, deklarat objekt shqyrtimi, nuk përfshihen në format më të rënda të “*gjuhës së urrejtjes*”, të cilat mohojnë vlerat themelore të KEDNJ dhe që janë të përjashtuara nga mbrojtja e KEDNJ-së, parashikuar nga neni 17, i saj. Ato do të trajtohen në kuadër të kategorisë së dytë, si një formë “më pak e rëndë” e “gjuhës së urrejtjes”, që në analizë të kriterëve të vendosura nga neni 10 i KEDNJ, mund t’i nënshtrohet kufizimeve.

Relacioni Shpjegues që shoqëron Rekomandimin Nr. 15 të Politikës së Përgjithshme të ECRI-t “*Për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes*”, thekson se, një nga elementët domethënës të konceptit se çfarë është gjuha e urrejtjes, lidhet me *përdorimin që synon jo thjesht të nxisë kryerjen e akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, por edhe pritshmërinë e arsyeshme që ky përdorim të ketë këto efekte*. Relacioni Shpjegues i Rekomandimit Nr.15, të ECRI-t, në pikën 16, të tij, përcakton se, vlerësimi nëse ekziston rreziku i akteve përkatëse, pra i akteve të dhunës, frikësimit, armiqësisë apo diskriminimit, që të ndodhin duhet të merret duke pasur parasysh rrethanat specifike në të cilat përdoret gjuha e urrejtjes dhe konkretisht duhet të vlerësohen këto elementë:

- (a) *kontekstin në të cilin po përdoret gjuha e urrejtjes në fjalë* (konkretisht, nëse ekzistojnë tashmë tensione të rënda brenda shoqërisë ku përcillet kjo gjuhë e urrejtjes).
- (b) *aftësinë e personit që përdor gjuhën e urrejtjes për të ushtruar ndikim mbi të tjerët* (p.sh. duke qenë udhëheqës politik, fetar ose në komunitet);

²⁰ GJEDNJ, *Carl Jóhann Lilliendahl kundër Islandës*, Aplikimi nr. 29297/18, Vendimi datë 12 maj 2020.

- (c) *natyrën dhe forcën e gjuhës së përdorur* (p.sh. nëse është provokuese dhe e drejtpërdrejtë, përfshin përdorimin e keqinformimit, stereotipizimin negativ dhe stigmatizimin, ose është në gjendje të nxitë akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi);
- (d) *kontekstin e komenteve specifike* (nëse janë një dukuri e izoluar ose janë ritheksuar disa herë dhe nëse ato mund të vlerësohen si të kundërbalancuara nga të tjerët ose nga vetë folësi apo dikush tjetër, sidomos gjatë një debati);
- (e) *mediumin (formatin) e përdorur* (nëse mundëson përgjigje të menjëhershme nga publiku, për shembull një aktivitet që ndodh "direkt"); dhe
- (f) *natyrën e publikut* (nëse ka në dispozicion mjetet dhe prirjen apo ndjeshmërinë për t'u përfshirë në akte dhune, frikësimi, armiqësie ose diskriminimi)

Në shtojcën e Rekomandimit KM/Rek (2022)16, të Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, për shtetet anëtare për masat për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, theksohet se, meqenëse gjuha e urrejtjes mbulon një sërë shprehjesh urrejtjeje, të cilat ndryshojnë në ashpërsinë e tyre, dëmin që shkaktojnë dhe ndikimin e tyre te anëtarët e grupeve të veçanta në kontekste të ndryshme, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që një sërë masash për të parandaluar dhe luftuar efektivisht gjuhën e urrejtjes. Një qasje e tillë gjithëpërfshirëse duhet të përputhet plotësisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata) dhe duhet të bëjë dallimin ndërmjet:

- i. gjuhës së urrejtjes që është e ndaluar sipas ligjit penal;
- ii. Gjuhës së urrejtjes që nuk arrin nivelin e ashpërsisë së kërkuar për përgjegjësinë penale, por megjithatë i nënshtrohet *ligjit civil ose administrativ*;
- iii. Llojet fyese ose të dëmshme të shprehjes, të cilat nuk janë mjaftueshëm të rënda për t'u kufizuar në mënyrë legjitime sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por megjithatë kërkojnë përgjigje alternative, siç janë: kundër-fjalimi dhe kundërmasa të tjera; masat që nxisin dialogun dhe mirëkuptimin ndërkulturor, duke përfshirë mediat dhe mediat sociale, dhe aktivitete përkatëse edukative.

Në Shtojcën e Rekomandimit KM/Rek (2022)16, theksohet se, në vlerësimin e ashpërsisë së gjuhës së urrejtjes dhe përcaktimin se cila lloj përgjegjësie, nëse ka vend për përgjegjësi, duhet t'i atribuohet ndonjë shprehjeje specifike, duhen ndjekur udhëzimet e dhëna nga praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ, duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm dhe ndërveprimi ndërmjet tyre: - *përmbajtja e shprehjes*; - *konteksti politik dhe social në kohën e shprehjes*; - *qëllimi i folësit*; - *roli dhe statusi i folësit në shoqëri*; - *si shpërndahet apo përforcohet shprehja*; - *aftësia e shprehjes për të çuar në pasojë të dëmshme, duke përfshirë afërsinë e pasojave të tilla*; - *natyra dhe madhësia e audiencës dhe karakteristikat e grupit të synuar*.

Duke ju referuar përmbajtjes dhe natyrës së shprehjeve të përdorura nga z. R.A : “histerike”, “je një figurë shumë e shëmtuar”, “figurë neveritëse” apo “perversitet”, “ajo zonja aty ta mbylli gojën”, “kakaris gjithë kohës”, Komisioneri vlerëson se këto shprehje, deklarata apo qëndrime janë fyese,

denigruese dhe stigmatizuese që synojnë të heshtin dhe të turpërojnë një grua për shkak të zërit të saj publik. Në debatin e zhvilluar gjatë emisionit, ankuesja ishte e vetmja grua në panel, që u sulmua për mënyrën e të folurit dhe pamjen. Ato përbëjnë sulm verbal ndaj një gruaje mbrojtëse e të drejtave të njeriut, e cila punon dhe ushtron aktivitetin e saj në mbrojtje të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave dhe vajzave.

Gjuha e urrejtjes për shkak të gjinisë/ Gjuha e urrejtjes seksiste, është një nga shprehjet e seksizmit, e cila mund të përkufizohet si çdo supozim, besim, pohim, gjest ose veprim që synon të shprehë përbuzje ndaj një personi, lidhur me gjininë e saj ose të tij, ose ta konsiderojë atë person si inferior/e ose thelbësisht të reduktuar ndaj dimensionit të saj apo të tij seksual. Gjuha e urrejtjes seksiste përfshin shprehje që përhapin, nxisin ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në gjini²¹.

Komisioneri evidenton faktin se, procesi i konsultimit dhe miratimit të projektligjit “Për barazinë gjinore” gjatë periudhës shtator-tetor 2025 është shoqëruar me tensione dhe debate në shoqëri, si dhe me sulme ndaj aktivisteve dhe anëtareve të organizatave të shoqërisë civile të cilat kanë mbështetur miratimin e ligjit “Për barazinë gjinore”. Emisioni “Off the Record”, i datës 28 tetor 2025, në televizionin A2CNN është transmetuar në këtë kontekst shoqëror, me tensione dhe debatet në lidhje me projektligjin “Për barazinë gjinore”, i cili ishte në procedura konsultimi pranë Kuvendit. Tema e emisionit ishte posaçërisht diskutimi në lidhje me projektligjin.

Në Raportin e Raportuesit Special mbi situatën e mbrojtëseve të të drejtave të njeriut “Situata e mbrojtëseve të të drejtave të njeriut të grave”, viti 2019, ndër të tjera theksohet²²:

Mbrojtëset gra, shpesh përballen me rreziqe dhe pengesa shtesë dhe të ndryshme (nga mbrojtësit burra) që janë të bazuara në gjini, të ndërthura dhe të formuara nga stereotipe gjinore të rrënjësura dhe ide e norma të thella rreth asaj se kush janë gratë dhe si duhet të jenë ato. Në klimën aktuale politike, në të cilën ka një reagim negativ kundër të drejtave të njeriut, mbrojtëset e grave janë shpesh të parat që sulmohen.

Një rezistencë më e madhe ndaj punës së grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut është shfaqur në nivele të shumëfishta dhe në shumë hapësira. Këto forma të rezistencës janë të lidhura me zhvillime më të gjera politike, siç është rritja e populizmit, fundamentalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ka pasur një rritje shqetësuese të fjalimeve mizogjine, seksiste dhe homofobike nga udhëheqës të shquar politikë në vitet e fundit, duke normalizuar dhunën ndaj grave.

Mbrojtëset e grave shpesh perceptohen si sfiduese të nocioneve tradicionale të roleve familjare dhe gjinore në shoqëri, një perceptim që mund të gjenerojë armiqësi nga aktorët shtetërorë dhe nga publiku, media dhe aktorë të tjerë jo shtetërorë. Ato mund të stigmatizohen dhe të përjashtohen nga

²¹ Këshilli i Evropës, *Factsheet on Combating Sexist Hate Speech*, 2016:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680651592>

²² <https://docs.un.org/en/A/78/131>

udhëheqësit e komunitetit, grupet fetare, familjet, fqinjët dhe komunitetet me bindjen se ato dhe veprimet e tyre janë një kërcënim për fenë, nderin, kulturën ose mënyrat e jetesës.

Një shqetësim i thellë është rritja e konceptit të "ideologjisë gjinore", siç është paraqitur nga udhëheqësit fetarë, politikanët dhe anëtarët e grupeve konservatore, të cilët, duke keqpërdorur çështjet gjinore, e përshkruajnë "ideologjinë" si një kërcënim për vlerat fetare, familjen dhe moralin në shoqëri. Sipas këtij këndvështrimi, të paraqitur me një vrull të veçantë në Amerikën Latine dhe Evropën Lindore, "ideologjia gjinore" pozicionohet si përpjekja nga mbrojtësit e të drejtave të njeriut të personave lezbike, gej, biseksualë dhe transgjinorë dhe atyre me orientime dhe identitete gjinore të ndryshme, si dhe nga feministët, për të destabilizuar rendin politik dhe shoqëror; kërcënimi i supozuar po përdoret për të formësuar rezultatet politike dhe për të justifikuar diskriminimin.

Gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut, në përgjithësi përballen me rreziqe dhe sfida më të mëdha sesa burrat, rreziqe që janë gjinore dhe ndërsektoriale. Përveç gjinisë, aspekte të identitetit të tyre, të tilla si mosha, feja, etnia, imigracioni ose statusi ligjor, aftësia e kufizuar, orientimi seksual, identiteti gjinor, shprehja gjinore dhe mënyra se si këto aspekte ndërthuren formojnë mënyrën se si gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut perceptohen dhe trajtohen. Gratë mbrojtëse nuk janë shënjestruar vetëm si individë; ato janë shënjestruar edhe sepse i përkasin rrjeteve, kolektivave dhe lëvizjeve, dhe sulmet kundër tyre kanë për qëllim të shërbejnë si paralajmërime për të tjerët.

Një mënyrë e fuqishme për të sulmuar mbrojtëset gra është dëmtimi i "nderit" ose reputacionit të tyre. Përpjekjet për të turpëruar gratë kanë çuar në stigmatizimin dhe izolimin e tyre. Në disa kontekste, gratë shpesh reduktohen në rolet e tyre si nëna, bija dhe kujdestare në vend që të shihen si aktore legjitime politike dhe ekonomike në të gjitha sferat e shoqërisë. Në veçanti, në shoqëritë konservatore, mbrojtëset gra përqeshen për përpjekjet e tyre për të krijuar ndryshim. Ato etiketohen si "nëna të këqija", "të vështira", "të liga", "të zhurmshme", "të këqija" ose "shtriga". Ato përshkruhen si "jobesimtare", "ateiste", "guerile", "separatiste", "armiku i brendshëm", "tradhtarë", "anti-nacionaliste" ose "terroriste".

Gratë që punojnë për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore veprojnë mbi çështje të ndryshme. Ato nxjerrin në pah se si ligjet dhe praktikat në lidhje me trashëgiminë, tokën dhe pronën i lënë vajzat dhe gratë të nënshtruara dhe të varfëra. Ato veprojnë për të eliminuar dhunën në familje, incestin, martesat e hershme dhe të detyruara, përdhunimin martesor dhe gjymtimin gjenital femëror. Ato bëjnë thirrje që gratë dhe vajzat të kenë autonomi për të marrë vendime në lidhje me jetën dhe trupat e tyre dhe për të pasur qasje në abort të sigurt dhe ligjor. Këto janë çështje që mund të perceptohen si sfiduese ndaj normave fetare dhe kulturore dhe mund të shkaktojnë një reagim të ashpër nga grupet fetare dhe konservatore.

Duke qenë një person publik, artist, z. R.A , për shkak të statusit të tij në shoqëri ka aftësi për të ndikuar tek një publik i gjerë. Duke u bazuar tek statusi i tij, z.R.A mbart detyrime të shtuara, në

raport me persona të tjerë të cilët nuk kanë një profil publik, për të treguar një vigjilencë të shtuar në lidhje me gjuhën që përdor gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes. Për shkak të statusit dhe ndikimit që ka tek të tjerët, ai duhet të tregojë një përgjegjshmëri më të madhe në lidhje me gjuhën e përdorur për të transmetuar qëndrimet, mendimet apo mesazhet.

Përhapja e deklaratave/shprehjeve në fjalë nëpërmjet OSHMA audiovizive sikurse është Televizioni A2 CNN, ka fuqinë dhe mundësinë që të arrijë te një publik shumë i gjerë. Për më tepër, pjesë nga emisioni ku janë bërë deklaratat janë publikuar dhe shpërndarë nga ana e Televizioni A2 CNN në platformat e tjera online që kjo media ka në rrjetet sociale si *YouTube*, ku rezulton se emisioni figuron ende i publikuar i plotë, duke qerë që të zmadhohet akoma më shumë ndikimi që mund të ketë gjuha e përdorur.

Përfundimisht, duke marrë në konsideratë të gjitha aspektet e analizuara më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, gjuha e përdorur nga z. R.A , përbën gjuhë urrejtje kundër grave mbrojtëse të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe të drejtave të grave dhe vajzave, për shkak të gjinisë, bindjeve filozofike dhe statusit.aktivitetit në mbrojtje të të drejtave të njeriut . Mendimet dhe qëndrimet e shprehura nga z.R.A janë në tejkalim të lirisë së shprehjes dhe si të tilla ato nuk mund të gëzojë mbrojtje nga nenet 22 i Kushtetutës, nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenit 19 të Paktit ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Për të gjitha arsyet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional.

Kuadri ligjor dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtës për barazi dhe mosdiskriminim, vendosin detyrime si ndaj autoriteteve publike ashtu dhe subjekteve private, që jo vetëm të mos përdorin gjuhë urrejtje, por edhe të marrin masa e duhura për ta parandaluar dhe luftuar.

Në mënyrë të shprehur, ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”, vendos detyrimin mbi median që të shmangë raportimin diskriminues mbi baza gjinore, dhe ndalimit, transmetimit, botimit dhe publikimit të materialeve dhe informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njërës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë, në veprimtarinë e vet. Ndërsa legjislacioni i posaçëm që rregullon ushtrimin e veprimtarisë së mediave audiovizive, ligji nr. 97/2013 “*Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit të Mediave Audiovizive, i miratuar nga AMA, vendos detyrime mbi OSHMA që të parandalojnë dhe luftojnë seksizmin në media, gjuhën stereotipizuese me sfond gjinor, diskriminimin gjinor, të promovojnë barazisë gjinore, si dhe të luftojnë dhe parandalojnë gjuhën e urrejtjes, nëpërmjet marrjes së një sërë masash të cilat janë të përcaktuara në këto akte.

Pavarësisht se nuk është objekt i ankesës objekt shqyrtimi, Komisioneri cmon ndalet tek acosimi i pedofilisë me personat LGBT.

Termi “*pedofili*”, ka një sërë përkufizimesh, të cilat gjenden në fushen e mjekësisë, psikologjisë, në gjuhën e përditshme të folur, dhe në konceptin e zbatimit të ligjit.

Në qarqet e zbatimit të ligjit, si në legjislacionin penal, termi pedofil, përdoret në mënyrë të gjere, duke përfshirë një person i cili kryen një ose më shumë krime seksuale dhe ku viktima është ligjrisht i mitur.

Si një diagnozë mjekësore, pedofilia është një çrregullim mendor dhe karakterizohet në mënyrë tipike nga një interes primar apo ekskluziv seksual ndaj fëmijëve në moshën para pubertetit.

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka miratuar *Klasifikimin Ndërkombëtar të Sëmundjeve, Rishikimi i 11-të (ICD-11)*. ICD-11, u miratua nga Asambleja e 72-të Botërore e Shëndetësisë në vitin 2019 dhe hyri në fuqi më 1 janar 2022²³. Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve, wshtw standardi global për informacionin diagnostik shëndetësor.

ICD-11, e klasifikon “*pedofolinë*” në kategorinë “06 - Çrregullime mendore, të sjelljes ose neurozhvillimore”²⁴, në kuadër të “Çrregullime parafilike”, të cilat shpjegohen si vijon: “Çrregullimet parafilike karakterizohen nga modele të qëndrueshme dhe intensive të ngacmimit seksual atipik, të manifestuara nëpërmjet mendimeve, fantazive, shtysave ose sjelljeve seksuale, fokusi i të cilave përfshin persona të cilët, për shkak të moshës ose gjendjes së tyre, nuk janë të gatshëm ose të aftë të japin pëlqimin, dhe ndaj të cilave personi ka vepruar ose nga të cilat është shqetësuar ndjeshëm. Çrregullimet parafilike mund të përfshijnë modele ngacmimi që përfshijnë sjellje individuale ose individë që japin pëlqimin, vetëm kur këto shoqërohen me shqetësim të theksuar, i cili nuk është thjesht rezultat i refuzimit ose frikës nga refuzimi i modelit të ngacmimit nga të tjerët, ose me rrezik të konsiderueshëm të lëndimit ose vdekjes.”. Çrregullimi Pedofilik (6D32), përbën një nga çrregullimet parafilike. ICD-11, jep këtë shpjegim për “Çrregullimin Pedofilik”: “Çrregullimi Pedofilik, karakterizohet nga një model i qëndrueshëm, i fokusuar dhe intensiv i ngacmimit seksual, i manifestuar nëpërmjet mendimeve, fantazive, shtysave ose sjelljeve seksuale të vazhdueshme, që përfshin fëmijë para pubertetit. Për më tepër, që të diagnostikohet Çrregullimi Pedofilik, individi duhet të ketë vepruar sipas këtyre mendimeve, fantazive ose shtysave, ose të jetë shqetësuar ndjeshëm prej tyre. Ky diagnozë nuk zbatohet për sjelljet seksuale ndërmjet fëmijëve para ose pas pubertetit me bashkëmoshatarë që janë afërsisht të së njëjtës moshë.”²⁵

Komisioneri thekson se, asocimi i pedofilisë me personat LGBTI, është e pabazuar dhe keqinformon publikun. Diskutimi mbi informacione jo të bazuara sjell krijimin e paragjykimeve dhe stigmatizimin e personave që i përkasin LGBTI. Ligjërime apo fjalime të tilla, të cilat i portretizojnë personat LGBT si kërcënim për shoqërinë, duke i stigmatizuar dhe duke i etiketuar ata në një mënyrë negative dhe me attribute të pavërteta, krijojnë në radhët e publikut dhe

²³ [https://www.who.int/news/item/11-02-2022-who-s-new-international-classification-of-diseases-\(icd-11\)-comes-into-effect](https://www.who.int/news/item/11-02-2022-who-s-new-international-classification-of-diseases-(icd-11)-comes-into-effect)

²⁴ <https://icd.who.int/browse/2026-01/mms/en#334423054>

²⁵ <https://icd.who.int/browse/2026-01/mms/en#517058174>

veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mire informuar, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, nxisin qëndrime negative, stimulojnë frikën, dhe nxisin diskriminimin ndaj komunitetit LGBT. Të tilla ligjërime apo fjalime përbëjnë gjuhë urrejtje dhe janë të ndaluara sipas LMD²⁶.

Televizioni A2 CNN, është përgjegjës, jo vetëm se gjatë zhvillimit të debatit drejtuesi i emisionit nuk ka kundërshtuar dhe hedhur poshtë deklaratat e z.Aliaj, por edhe për shkak të përhapjes së gjuhës së urrejtjes të përdorur nga z.R.A gjatë emisionit “Off the Record”, të datës 28.10.2025. Pavarësisht se emisioni ka qenë në transmetim të drejtpërdrejtë, televizioni A2 CNN, ka publikuar emisionin e plotë të platformat e tij online sikurse *youtube*.

Duke mbajtur në konsiderate qëndrimin e televizionit A2 CNN, si dhe në kushtet kur ndaj tij është marrë masa administrative nga ana e AMA, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës dhe nga ana e palës ankuese nuk janë ngritur pretendime ndaj televizionit, por vetëm ndaj z.R.A , Komisioneri çmon se nuk është e nevojshme që të disponojë në këtë vendim në lidhje me përgjegjësinë e televizionit A2 CNN.

Në nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa mbështetur në nenin 33, pika 12, të po këtij ligji, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”. Ligji nuk ka përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për rregullimin e situatës diskriminuese, atribut ky që është lënë në diskrecionin e Komisionerit. Në këtë kontekst, Komisioneri vendos rast pas rasti, se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të individëve që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese duhet të jetë detyrimi i z.R.A që të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj. Në kushtet kur, emisioni “Off the Record”, i datës 28.10.2025, ku janë bërë deklaratat e z.R.A , të cilat përbëjnë gjuhë urrejtje, vijon të jetë i publikuar i plotë në kanalën në *Youtube* të Televizionit A2 CNN²⁷, ky i fundit duhet të marrë masa për të hequr deklaratimet që përbëjnë gjuhë urrejtje.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

²⁶ Shiko: Vendimi Nr. 58, datë 08.05.2013, i Komisionerit.

²⁷ <https://www.youtube.com/watch?v=B3KixujrXto&t=1331S>

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuses M.A , për shkak të gjinisë, bindjeve filozofike dhe statusit të saj si mbrojtëse e të drejtave të njeriut, pasi gjuha e përdorur nga shtetasi R.A në emisionin “Off the Record”, transmetuar në datë 28.10.2025 në Televizionin A2 CNN, përbën diskriminim në formën e “gjuhës së urrejtjes”.
2. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi shtetasi R.A , në cilësinë e personit i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të bëjë një deklaratë publike (verbale ose të shkruar) me anë të të cilës distancohet nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e saj.
3. Në referim të pikës 1 të këtij vendimi, Televizioni A2 CNN/Shoqëria G2 Media sh.p.k, duhet:
 - a. Të marrë masa për heqjen e deklarimeve të përbëjnë gjuhë urrejtje, nga përmbajtja e emisionit “Off the Record”, datë 28.10.2025, transmetuar në Televizionin A2 CNN, të publikuar në kanalin zyrtar në rrjetin social *youtube*²⁸.
 - b. Të marrë masa efektive për të parandaluar që situata të tilla të mos përsëriten në të ardhmen dhe për të mos lejuar në asnjë rast përdorimin dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, shtetasi R.A , duhet të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Gjinia, bindjet filozofike, statusi si “mbrojtëse e të drejtave të njeriut”
Lloji i vendimit: Diskriminim_Gjuhë urrejtje

²⁸ <https://www.youtube.com/watch?v=B3KixujrXto&t=1331S>